



Universiteti i Evropës Juglindore

STUDIME POSTDIPLOMIKE –CIKLI I DYTË

TEZA:

E drejta e arsimimit dhe parimi i mosdiskriminimit

Kandidati:

Teuta Zylfiqari

Mentori:

Prof.Asoc.Dr. Agron Rustemi

Shkup, 2020

Deklaratë:

Unë, Teuta Zylfiqari, studente në Universitetin e Europës Juglindore- Tetovë , deklaroj se jam autore e punimit dhe mbaj përgjegjësi për origjinalitetin e të njejtit.

Teuta Zylfiqari -Ademi

Lektoroi :

Doc.dr. Luljeta Adili-Çeliku

Përmbajtja:

ABSTRAKT.....	5
HYRJE.....	7
1. FUSHA E HULUMTIMIT.....	8
2. QËLLIMET E HULUMTIMIT	8
3. HIPOTEZAT.....	9
4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	9
5. RËNDËSIA E TEZAVE.....	10
KAPITULLI I: E DREJTA E ARSIMIMIT – NORMAT JURIDIKE NDËRKOMBËTARE DHE LIGJSHMËRIA	11
1.1 INSTRUMENTET E KOMBEVE TË BASHKUARA	11
1.2 INSTRUMENTET E KËSHILLIT TË EVROPËS	17
1.3 STANDARDET E UNESCO-S	20
1.4 STANDARDET E BASHKIMIT EVROPIAN	22
KAPITULLI II: IMPLEMENTIMI I SË DREJTËS SË ARSIMIMIT	24
2.1. ORGANIZIM DHE PËRMBAJTJA E ARSIMIMIT	24
2.2. SANKSIONIMI I SË DREJTËS SË ARSIMIMIT	26
2.3. NORMATIVI I SË DREJTËS SË ARSIMIMIT: PROCEDURAT DHE MASAT E NDJEKJES	31
2.4. E DREJTA E ARSIMIT NË PËRPUTHJE ME LIGJVËNIEN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	38
KAPITULLI III: REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT DHE IMPLAMENTIMI I SË DREJTËS SË ARSIMIMIT DHE MOSDISKRIMINIMIT	41
3.1. RAPORTI I TRUPAVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT PRANË KOMBEVE TË BASHKUARA	41

3.2. KËSHILLI EVROPIAN: RAPORTI I KOMISIONIT EVROPIAN KUNDËR RACIZMIT DHE JOTOLERANCËS	47
3.3. KOMISIONI EVROPIAN: RAPORTI I PROGRESIT I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	52
3.4 ANALIZË E TË DHËNAVE STATISTIKORE PËR REALIZIMIN E TË DREJTËS SË ARSIMIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT.....	55
3.5 ANALIZË E INTERVISTAVE TË REALIZUARA ME QYTETARËT E REPUBLIKËSSË MAQEDONISË SË VERIUT.....	61
REKOMANDIME DHE KONKLUZA PËRMBYLLËSE.....	65
BIBLIOGRAFIA.....	70

Abstrakt

Kjo tezë e magistraturës merret me të drejtën e arsimimit dhe me parimin e mosdiskriminimit në arsim. Në fakt, në këtë tezë bëhet analizë rregullativave dhe normave ndërkombëtare juridike e cila është e lidhura me të drejtën e arsimimit me theks të veçantë në instrumentet e Kombeve të Bashkuara, Këshillit Evropian, UNESCO-s dhe Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, në këtë punim vëmendja është e përqëndruar edhe kah e drejta e arsimimit dhe mosdiskriminimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Për këtë qëllim, bëhet analizë e së drejtës së arsimimit në Maqedoni, në përputhje me ligjvënien maqedonase, si dhe analizë e raporteve të ndryshme për Republikën e Maqedonisë së Veriut nga ana e Komitetit për të Drejtat e Njeriut pranë OKB-së dhe nga ana e Këshillit Evropian.

Duke e pasur parasysh gjendjen dhe përbërjen multietnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është jashtëzakonisht e rëndësishme analiza e bërë në kuadër të këtij punimi, sa i përket rregullativës ligjore që ka të bëjë me arsimimin dhe me zbatimin e tij në mes të etnive të ndryshme, duke bërë krahasim me ligjvënien e BE-së.

Arsimimi është njëri ndër shtyllat kryesore në të cilën mbështet çdo shoqëri, etni dhe në kuptimin më të gjerë të fjalës, shtet apo globalisht, e tërë bota. Kjo është një e drejtë e cila i takon çdo njeriu në mënyrë të barabartë, në mënyrë univernale dhe në mënyrë të pandërprerë, duke pasqyruar edhe nevojat themelore të njeriut, pa të cilat njeriu nuk mund të jetojnë me dinjitet. Për këtë shkak, kjo e drejtë duhet të jetë prioritet në tërë botën, duhet të jetë interes kombëtar i secilit vend.

Апстракт

Овој магистерски труд се занимава со правото на образование и принципот на недискриминација во образованието. Имено, во овој труд се врши анализа на меѓународните правни норми и регулативи кои се поврзани со правото на образование со посебен акцент на инструментите на Обединетите Нации, Европскиот Совет, УНЕСКО и Европската унија.

Исто така, во овој труд фокусот е насочен кон правото на образование и принципот на недискриминација во Република Северна Македонија. За таа цел се врши анализа на правото на образование во Македонија во согласност со македонското законодавство, како и анализа на различни извештаи за Република Северна Македонија од Комитетот за човекови права при ООН како и Советот на Европа.

Земајќи ја предвид состојбата и мултиетничкиот состав на Република Северна Македонија, од голема важност е анализата направена во овој труд во однос на законската регулатива поврзана со образованието и примената меѓу различните етникуми, правејќи споредба со законодавството на ЕУ.

Образованието е еден од основните столбови на кои почива секоја заедница, општество и, во поширока смисла, државата и глобално целиот свет. Тоа е човечко право кое припаѓа на секој човек, подеднакво, универзално и вечно, одраз на основните човечки потреби без кое луѓето не можат да живеат достоинствено. Затоа, тоа треба да биде приоритет низ целиот свет, национален интерес на секоја земја.

Hyrje

E drejta e arsimimit mund të përkufizohet si një e drejtë të cilën e posedon secili individ. Kjo e drejtë çdo individ do të duhej t'i sigurojë përfitimin e njohurive të caktuara të cilat do t'i mundësonin që ta gjejë vendin e tij në kuadër të shoqërisë, si dhe të japë kontributin e tij në të. E drejta e arsimimit, individit i jep më shumë kontrollë ndaj jetës së tij, duke i mundësuar t'i gëzojë të mirat dhe mirëqenien që vijnë nga të drejtat tjera: ato qyteatre dhe politike, siç janë: e drejta e lirisë së informimit, liria e shprehjes, e drejta e zgjedhjes dhe të qenët i zgjedhur, si dhe shumë të drejta kulturore dhe sociale, si që janë: e drejta e zgjedhjes së punësimit, e drejta e të ardhurave të barabarta për punën e barabartë, e drejta e të qenët i kënaqur nga rezultatet e avancimit shkencor dhe teknologjik, si dhe e drejta për pjesëmarrje në jetën kulturore.

Arsimimi duhet të bazohet në parimet e gjasave dhe meritave të barabarta në mënyrë që të jemi në shërbim të mirëqenies shoqërore. Në këtë mënyrë, ideal i shoqërisë bashëkohore e cila synon realizimin e barazisë në të gjitha sferat e jetës shoqërore, duke përfshirë këtu edhe arsimimin, është shoqëri në të cilën mbretëron parimi i mosdiskriminimit.

Diskriminimi në arsim mund të paraqitet në çdo segment të procesit vijues: gjatë regjistrimit në institucionin arsimor, në procesin e formimit dhe funksionimit të trupave mësimor, në komunikimin e përditshëm dhe në marrëdhëniet e ndërsjellta ndërmjet pjesëmarrësve, përmes procesit mësimor, përmbajtjet e librave, gjatë respektimit të rregullave të shkollës, gjatë mbështetjes nga diskriminimi apo dhuna në shkollë, gjatë qasjes të së drejtës për t'u arsimuar, gjatë vërtetimit të arritjeve të nxënësve, etj.

Pikërisht e drejta e arsimimit dhe parimi i mos diskriminimit janë lënda e kësaj teze të magistraturës. Në pjesën hyrëse janë prezantuar qëllimet, hipotezat dhe metodologjia e punës, si dhe rëndësia e problematikës së zgjedhur. Kapitulli i parë ka të bëjë me të drejtën e arsimimit duke i prezantuar rregullativat dhe normat ndërkombëtare. Kapitulli i dytë jep pasqyrim të implementimit të së drejtës së arsimimit, ndërsa kapitulli i tretë ka të bëjë me gjendjen në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sa i përket së drejtës së arsimimit dhe mosdiskriminimit. Në fund janë paraqitur edhe pikëpamjet dhe konkluzat nga ana e autorit dhe lista e literaturës së shfrytëzuar.

1. Fusha e hulumtimit

Bazë për përzgjedhjen e kësaj teme janë problemet aktuale, sa i përket të drejtës së arsimimit dhe kompleksiteti i tyre. Edhe pse kjo e drejtë ka qenë lëndë e punës e shumë organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare, fatkeqësisht, propozimet dhe politikat e tyre në shumë raste nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur.

Në bazë të marrëveshjeve për të drejtat e njeriut, e drejta e arsimimit është e drejtë esenciale e njeriut, së bashku me të drejtat tjera, duke përfshirë këtu të drejtën e punës, të drejtën e shëndetit dhe të drejtën e pjesëmarrjes politike. Marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në mënyrë të qartë dhe precize e definojnë të drejtën e arsimimit. „Shtetet e kanë për obligim të sigurojnë shkollimin fillor obligativ dhe pa pagesë për të gjithë fëmijët“. Ato duhet të sigurojnë edhe arsimin e mesëm që do të jetë në dispozicion për të gjithë, si dhe arsimin e lartë sipas shkathtësive. Shtetet, gjithashtu janë të obliguara që të fuqizojnë shkollimin fillor duke e eliminuar analfabetizmin, për të rriturit të cilët nuk i kanë kënaqur nevojat e tyre elementare për të mësuar. Barazia dhe mos diskriminimi, janë aspekte të rëndësishme të së drejtës së arsimimit dhe shtetet duhet të japin prioritet të qasjes së barabartë edhe për grupet tjera, siç janë: vajzat, fëmijët me aftësi të veçanta, minoritetet dhe fëmijët refugjatë.

2. Qëllimet e hulumtimit

Ky punim shkencor duhet t'i analizojë dhe shkurtimisht t'i përshkruajë normat juridike ndërkombëtare dhe regulativat të cilat kanë të bëjnë me të drejtën e arsimimit me theks të veçantë te instrumentet e Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, UNESCO-s dhe Bashkimit Evropian. Gjithashtu, ky punim do të orvatet të përgjigjet edhe në pyetjen për të drejtën e arsimimit dhe parimit të mosdiskriminimit përmes analizës së organizimit dhe përmbajtjes së arsimimit, sanksionimit të së drejtës së arsimimit, procedurave për ndjekjen dhe monitorimin e masave.

Njëri ndër qëllimet e këtij hulumtimi është shqyrtimi dhe analiza e së drejtës së arsimimit dhe parimit të mosdiskriminimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Për këtë qëllim do të shqyrtohet e drejta e arsimimit në Maqedoni, në përputhje me ligdhënien

maqedonase. Gjithashtu, do të shqyrtohen raporte të ndryshme për Republikën e Maqedonisë së Veriut nga ana e Komitetit për të Drejtat e Njeriut pranë OKB-së, si dhe nga Këshilli Evropian.

Përmes shqyrtimit të raporteve në fjalë, hulumtimi duhet të dëshmojë nivelin e respektimit të së drejtës së arsimimit dhe parimit të mosdiskriminimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht të dëshmojë se a ekziston boshllëk ndërmjet normave të deklaruara juridike dhe regullativave dhe zbatimit të këtyre të drejtave themelore në praktikë.

3. Hipotezat

1. Sigurimi i qasjes së arsimimit është parakusht për realizimin e tërësishëm të së drejtës së arsimimit. Pa qasje, nuk është e mundur të garantohet e drejta e arsimimit.
2. Implementimi i së drejtës së arsimimit që del nga një numër i madhi normave ndërkombëtare është realizuar pjesërisht
3. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut në mënyrë deklarative është e garantuar e drejta e arsimimit, e shprehur në kuadër të ligjvënies përmes Kushtetutës, përmes ligjeve si dhe përmes rekomandimeve dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare.
4. Republika e Maqedonisë së Veriut nuk e respekton në tërësi të drejtën e arsimimit dhe parimin e mosdiskriminimit.
5. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet të bëjë më shumë përpjekje për zbatimin e së drejtës së arsimimit dhe parimit të mosdiskriminimit.

4. Metodologjia e hulumtimit

Fusha e hulumtimit dhe kompleksiteti i saj, kërkon zgjedheje të vëmendshme të metodologjisë dhe analizave të hulumtimit. Në këtë punim shkencor janë përdorur metodat shkenore vijuese:

- Deskriptive – metod historik: për prezantimin e rezultateve nga hulumtimi dhe tashmë normat e prezantuara ligjore, dokumente dhe raporte të publikuara nga organizata dhe

institucione të ndryshme, siç janë: Organizata e Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian, Këshilli Evropian, etj.

- Metoda analitike: për analizën e dokumenteve të ndryshme, raporteve, të dhënave statistikore të publikuara nga organizata dhe institucione të ndryshme.
- Metoda komparative: kjo metodë do të shërbejë si udhërefyes me qëllim që të bëhet krahasimi ndërmjet kombeve dhe vendeve të ndryshme.

Në hulumtim është e përfshirë edhe intervista me qëllim që të vihet re mendimi dhe qëndrimet e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Intervista është zhvilluar me persona të grupmoshave të ndryshme, të dy gjinive, të grupeve të ndryshme etnike dhe të nivelit të ndryshëm të arsimit – me qëllim të marrjes së rezultateve sa më objektive.

5. Rëndësia e tezave

Duke pasur parasysh gjendjen dhe përbërjen multietnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është tejet e rëndësishme të shqyrtohet rregullativa ligjore sa i përket arsimimit dhe zbatimit në mes të etnive të ndryshme, duke krahasuar ligjdhënien e BE-së dhe implementimin e tij. Gjithashtu, përfshirja dhe rëndësia e politikave dhe instrumenteve të OKB-së, do të jenë të rëndësishme në hulumtimin e kësaj teme.

Rëndësia e këtij punimi bëhet gjithnjë e më e madhe, në qoftë se kemi parasysh se deri më tani, lidhur me këtë çështje në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë bërë shumë pak hulumtime. Si i tillë, ky punim shkencor mund të shërbejë edhe si bazë për hulumtime të mëtejme për studentët, për palëtë e interesuara dhe për hulumtuesit e kësaj fushe.

Kapitulli I

E drejta e arsimimit – normat ndërkombëtare juridike dhe ligjvënja

1.1 Instrumentet e Kombeve të Bashkuara

Arsimimi është proces me anë të së cilit shoqëria i transmeton apo i shpërndanë njohuritë e fituara, shkathtësitë dhe vlerat nga një gjeneratë, në gjeneratë tjetër, e që nga kohërat e lashta për ta bërë këtë, kanë ekzistuar forma të ndryshme. Përmbajtja, qëllimet por edhe shfrytëzuesit e tij, janë zhvilluar gjatë historisë në të gjitha pjesët e botës, pa formuar asnjëherë një unitet, të paktën jo deri në shpalljen e Deklaratës së Përgjithshme të së Drejtave të Njeriut, nga 10 dhjetori i vitit 1948 dhe nga neni 26 me temë, e drejta e arsimimit.

Në fakt, deri në Luftën e Parë Botërore, e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut i ka mbrojtur vetëm kategoritë e personave të cënuar: mbrojtje ndaj të plagosurve në luftë (Konventa e Gjenevës nga viti 1864), mbrojtja e pakicave kombëtare pas Luftës së Parë Botërore, ose mbrojtja e punëtorëve nën mbrojtjen e Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Në vitin 1945, punët ndryshojnë dhe gjithpërfshirja e së drejtave të njeriut bëhet temë qëndrore e diskutimeve në kuadër të Kombeve të Bashkuara, gjë që vërehet edhe në nenin 1 nga Karta e 26 dhjetorit 1945, e cila organizatës ia delegon misionin vijues: „...*të zhvillojë bashkëpunim ndërkombëtar për zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare të natyrës ekonomike, sociale, kulturore apo humanitare, si dhe zhvillimin dhe inkurajimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë, pa dallim race, gjinie, gjuhe, apo religjioni*“. Për këtë qëllim është formuar Komisioni i të Drejtave të Njeriut i cili nga ana tjetër, ka formuar një këshillë drejtues me përfaqësues të vendeve si: Australia, Kili, Kina, SHBA-ja, Franca, Libani, Britania e Madhe dhe BRRSS-ja.

Draft deklarata ka kaluar nëpër disa revizione, ndryshime dhe riorganizime para se Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10 dhjetor 1948, ta miratojë Deklaratën e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, ashtu siç e njohim edhe sot. Neni

26, i cili e siguron të drejtën e arsimimit është miratuar më 53 vota pro, 0 kundër dhe 3 abstenime.

Deklarata universale për të drejtat e njeriut është instrumenti i parë juridik që e pranon arsimimin si e drejtë njerëzore. Në nenin 26 thuhet: „*Secili ka të drejtë të arsimohet*“. Ky është instrument i obliguar joligjor, por me fuqi të madhe morale dhe politike.

Neni 26 thotë¹: „1. *Secili ka të drejtën e arsimimit. Arsimimi do të jetë falas, të paktën në nivel të arsimit fillor. Arsimi fillor do të jetë i obligueshëm. Arsimi teknik dhe profesional do të jenë në përgjithësi në dispozicion, ndërsa qasja drejt arsimit të lartë do të jetë në dispozicion të secilit, në bazë të suksesit.*

2. *Arsimimi do të orientohet drejt zhvillimit të tërësishëm të personalitetit njerëzor dhe drejt fuqizimit dhe respektimit të së drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Me anë të tij do të avancohet mirëkuptimi, toleranca dhe miqësia ndërmjet të gjitha kombeve dhe racave religjioneve dhe do të avancohen aktivitetet e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.*

3. *Prindërit e gëzojnë të drejtën parimore për të zgjedhur llojin e arsimimit që do t’ua ofrojnë fëmijëve të tyre.*“

Neni 26 nga Deklarata e Përgjithshme e së Drejtave të Njeriut përfshinë tri drejtime të ndryshme: i pari ka të bëjë me qasjen e arsimimit, i dyti me përmbajtjen dhe qëllimin e arsimimit dhe i treti me të drejtën parimore të prindërve në përzgjedhjen e arsimimit për fëmijët e tyre.

Me Deklaratën e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut janë shpallur dy “shtylla” kryesore të edukimit bazik dhe të arsimimit në shoqërinë bashkëkohore, domosdoshmëria dhe mos pagesa², të cilat gjenden në përmbajtjet e të gjitha dokumenteve të mëvonshme të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. Nga ajo kohë, arsimimi, nuk është vetëm lëndë e bisedimeve politike dhe filozofike, të praktikës edukative-arsimore, por është e drejtë, më saktësisht, e drejtë e njeriut. Ky definicion është i rëndësishëm për shkak se e definon gatishmërinë e bashkësisë ndërkombëtare për të vërtetuar themelet të së drejtave të pa cënueshme dhe të të gjitha të drejtave, pa bërë dallime. Me anë të kësaj deklarate, vendet

¹https://unicode.org/udhr/d/udhr_mkd.html, qasur më 15.04.2020

²Tomaševski, K. (2006) Human rights obligations in education: The 4-A Scheme. Nijmegen: Wolf Legal Publishers

anëtare të Kombeve të Bashkuara, të drejtën e arsimimit, e shëndrruan në të drejtë themelore për çdo njeri.

Që nga miratimi i Deklaratës, e drejta e arsimimit është vërtetuar në shumë dokumente dhe deklarata për të drejtat e njeriut të miratuara nga ana e Kombeve të Bashkuara edhe atë³:

- **Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore nga viti 1966 (Neni 13 dhe Neni 14)**

Neni 13 përmban katë paragrafë. I pari, parimi ka të bëjë me elementet kryesore të nenit 26 nga Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut. Paragrafi i dytë në mënyrë të detajuar e definon përmbajtjen e obligimeve të vendeve anëtare, në mënyrë që të sigurohet efikasiteti i së drejtës së arsimimit. Këto obligime përmbajnë:

- sigurimin e arsimit fillor falas dhe obligativ;
- përgjithësimin e qasjes deri te arsimi i lartë, gjithashtu përmes vendosjes progresive të arsimit falas;
- dispozicion të arsimit të lartë për të gjithë në bazë të parimit të barazisë, përmes vendosjes progresive të arsimit falas;
- inkurajim dhe nivel më të lartë të qasjes deri tek arsimi fillor për të gjithë, duke përfshirë këtu edhe arsimin për të rriturit, të cilët nuk kanë pasur qasje në shkollimin fillor;
- zhvillimi i rrjetit të shkollave, vendsoja e sistemit të bursave dhe avancimin e kushteve materiale për kuadrin mësimor.

Paragrafi i tretë ka të bëjë me lirinë e prindërve, lidhur me arsimimin e fëmijëve të tyre. Garantohej liria, që prindërit, fëmijët e tyre t'i regjistrojnë në shkolla private të cilat duhet t'i respektojnë standardet minimale, të caktuara nga ana e shtetit, që kanë të bëjnë me arsimimin. Njëherit, prindërit janë të lirë të zgjedhin arsimimin fetar dhe moral për fëmijët e tyre. Paragrafi i fundit e garanton lirinë e cilitdo qoftë që hap shkollë, me kusht që të respektohen qëllimet e vendosura në artikullin e parë dhe standardet minimale, të cilat janë caktuar nga ana e shtetit.

³https://www.right-to-education.org/sites/right-to-education.org/files/resource-attachments/RTE_International_Instruments_Right_to_Education_2014.pdf, qasur më 15.04.2020

Neni 14 i kushton vëmendje të veçantë arsimimit apo shkollimit fillor falas dhe obligativ. Me këtë nen, obligohet vendet të cilat në momentin e ratifikimit, kanë zhvilluar atë lloj të arsimimit, të miratojnë plan për zbatimin apo realizimin e tij. Të dy nenet e shprehin përpjekjen në garantimin e obligimeve të shteteve dhe lirinë e prindërve, apo cilitdo personi tjetër, i cili e ka ndërmend të integrohet në kuadër të fushës së arsimimit.

- **Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, 1989 (Neni 28 dhe Neni 29)**

Për dallim nga dokumentet e lartëcekura, Konventa në fjalë e zgjeron vargun e obligimeve sa i përket së drejtës së arsimimit, duke i obliguar shtetet për:

- informimin e fëmijëve, prindërve, opinionin për shkollimin, si dhe përsosjen dhe drejtimin profesional;
- marrjen e masave për inkurajimin e pranisë së rregullt në mësim dhe uljen e përqindjes së çregjistrimit të fëmijëve nga shkolla;
- promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e arsimimit, sidomos me qëllim të luftës kundër analfabetizmit në tërë botën dhe lehtësim ndaj qasjes në njohuritë teknike dhe shkencore dhe metodave bashkëkohore mësimore;
- orientimin e fëmijëve drejt zhvillimit të tërësishëm të personalitetit, talentit, shkathtësive mentale dhe fizike, avancimit të së drejtave dhe lirive themelore të njeriut, respektimit të prindërve të fëmijëve, identitetit të tij kulturor, gjuhës dhe vlerave, si dhe të civilizimeve të cilat bëjnë dallim me ta;
- përgatitja e fëmijëve për një jetë të përgjegjshme në bashkësi të lirë, në frymën e mirëkuptimit, paqes dhe tolerancës, barazisë gjinore dhe miqësisë ndërmjet popujve dhe avancimit të mbrojtjes së mjedisit jetësor;
- zbatimin e disiplinës shkollore, në mënyrë që e vërteton dinjitetin njerëzor të fëmijëve.

- **Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (Neni 10)**

Vendet nënshkruese obligohen që t'i ndërmarin të gjitha masat përkatëse, në mënyrë që të eliminohet diskriminimi ndaj grave, me qëllim që të sigurohen të drejta të barabarta me burrat në fushën e arsimimit dhe sidomos të sigurohet barazi në arsimin njëlloj, për burrat dhe gratë:

- kushte të njëjta për karrierë dhe avancim profesional, për qasje deri në studime dhe për fitimin e diplomave nga institucionet arsimore në të gjitha kategoritë, në mjedise rurale dhe në ato urbane; kjo barazi do të sigurohet në arsimin parashkollor, fillor, teknik dhe profesional, si dhe në të gjitha llojet e trajnimit profesional;
 - qasje deri te kurikulimet e njëjta, deri te provimet, kuadri mësimor me kualifikime sipas standrdeve të njëjta dhe hapësira shkollore dhe pajisje të cilësisë së njëjtë;
 - eliminim i secilit koncept të stereotipuar rreth rolit të burrave dhe grave në të gjitha nivelet dhe në të gjitha format e edukimit, përmes inkurajimit të edukimit dhe llojeve tjera të arsimimit, të cilat do të ndihmonin të arrihej ky qëllim dhe në veçanti me anë të revizionit të librave dhe programeve shkollore dhe me anë të përshtatjes së metodave mësimore;
 - mundësi të barabarta për bursa dhe grante tjera të studimit;
 - mundësi të barabarta për qasje deri te programet për edukim të vazhdueshëm, duke përfshirë këtu edhe programet për të rritur dhe programet për mësimin e shkrim leximit, sidomos ato që kanë për qëllim që në afat sa më të shkurtër kohor, të zbusin çfardo boshllëku në kuadër të arsimimit ekzistent ndërmjet burrave dhe grave;
 - reduktimin e përqindjes së lënies së studimeve nga ana e grave dhe organizim të programeve për vajza dhe gra të cilat shumë herët kanë hequr dorë nga shkollimi;
 - mundësi të barabarta për të marrë pjesë aktive në sport dhe në arsimin fizik;
 - qasje deri te informatat specifike arsimore, në mënyrë që të sigurohet shëndet dhe mirëqenie të familjeve, duke përfshirë këtu edhe informatat dhe këshillat për planifikimin e familjes.
- **Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, 1966 (Neni 5 dhe Neni 7)**

Sipas nenit 5 shtetet nënshkruese obligohen të ndalojnë dhe eliminojnë diskriminim racor në të gjitha format dhe të garantojnë të drejtën e arsimimit dhe shkencës të gjithëve, pa dallim race, ngjyre apo përkatësie etnike. Me nenin 7 shtetet nënshkruese obligohen të miratojnë masa efektive dhe të menjëhershme, sidomos

nëlëminë e mësimdhënies, kulturës dhe informative, me qëllim të luftës kundër paragjytimeve të cilat shpien drejt diskriminimit racor dhe për promovimin e mirëkuptimit, tolerancës dhe miqësisë në mes të popujve, racave dhe grupeve etnike.

- **Konventë për të drejtat e personave me aftësi të veçanta, 2006 (Neni 24)**

Në përputhje me këtë Konventë, shtetet nënshkruese e pranojnë të drejtën e personave me aftësi të veçanta për t'u arsimuar, pa diskriminim dhe mbi baza të barabarta. Me qëllim të arritjes së kësaj të drejte, pa diskriminim dhe në baza të barabarta, shtetet nënshkruese duhet të sigurojnë sistem inkluziv të të gjitha niveleve të arsimit dhe mësim gjatë tërë jetës, të orientuar në drejtim të zhvillimit të tërësishëm të personave me aftësi të veçanta, zhvillim të shkathtësive të jetës dhe zhvillim social, si dhe pjesëmarrje të tyre efektive në kuadër të shoqërisë. Shtetet janë të obliguara të ndërmarrin masa përkatëse siç janë: lehtësimin e mësimin të shkrimit tëbrajtit, lehtësimin e mësimin tëgjuhës së shenjave, si dhe avancimin e identitetit linguistik të bashkësive të pjesëtarëve të shurdhër, sigurim të edukimit të personave, sidomos të fëmijëve, të cilët janë të verbër apo të shurdhër, në mënyrat më të përshtatshme, me anë të mjeteve të komunikimit që e maksimalizojnë zhvillimin e tyre akademik dhe social, si dhe sigurimin e kuadrit përkatës mësimor.

- **Konventa për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve, migrantëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre, 1990 (Neni 12.4, Neni30, Neni 43 dhe Neni 45)**

Kjo Konventë garanton për secilin fëmijë të punëtorit migrant, të drejtën themelore të qasjes në arsimim, në bazë të trajtimit të barabartë me shtetasit e shtetit përkatës edhe në rast të statusit të parregulluar të migrantit. Shteti siguron rregulla tjera për migrantët dhe për familjet e tyre, në fushën e arsimit dhe e garanton lirinë e prindërve në kuadër të arsimimit moral dhe fetar të fëmijëve të tyre.

- **Konventa në lidhje me statusin e refugjatëve, 1951 (Neni 22)**

Konventa e garanton të drejtën e arsimimit të refugjatëve.

- **Pakti Ndërkombëtar për të drejtat politike dhe qytatere, 1966 (Neni18)**

Në përputhje me këtë pakt, garantohet liria e mendimit, vetëdijes dhe religjionit në kuadër të të mësuarit dhe pranohet liria e prindërve të sigurojnë arsimimin fetar dhe moral për fëmijët e tyre, në përputhje me bindjet personale.

- **Deklarata⁴: Deklarata për të drejtat e personave që janë pjesë e minoriteteve etnike, religjioze dhe linguistike, 1992 (Neni 4); Deklarata për të drejtat e popujve autoktonë, 2007 (Nenet: 14, 15, 17 dhe 21); Deklarata për arsimim, trajnim dhe të drejta të njeriut, 2011.**

1.2 Instrumentet e Këshillit Evropian

Këshilli Evropian është organizata më e vjetër evropiane me seli në Strazbur, qëllimi kryesor i së cilës është fuqizimi i bashkëpunimit dhe uniteti i kontinentit evropian, përmes promovimit të së drejtave dhe lirive themelore të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Përveç këtyre tri shtyllave kryesore, të cilat paraqesin vlerat themelore të Organizatës, Këshilli Evropian ndalet edhe te një numër i madh i çështjeve specifike sociale, siç janë: përjashtimi social, jotoleranca racore, etnike dhe llojet tjera të jotolerancës, tregtia me njerëz, dhuna ndaj grave, e drejta e fëmijëve, bioetika, terrorizmi, mbrojtja kulturore dhe trashëgimia natyrore, si dhe sfida të tjera bashkëkohore të shoqërive evropiane.

E drejta e arsimimit është e vërtetuar në marrëveshje dhe në dokumente të shumta edhe nga ana e Këshillit të Evropës, në mesin e të cilave janë edhe:

- **Protokolli i 1 i Konvetës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, viti 1952 (neni 2)**

Sipas këtij protokolli asnjë personi nuk guxon t'i merret e drejta e arsimimit, ku me këtë rast, shtetit duhet ta respektojë të drejtën e prindërve për të siguruar arsim dhe mësim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.

- **Karta evropiane sociale e reviduar, viti 1996 (pjesa e 1 dhe nenet 7,10,15,17)**

Me këtë Kartë është rregulluar e drejta për zgjedhje personale për arsimin profesional, në përputhje me interes dhe shkathtësitë personale, si dhe e drejta për avancim dhe aftësim profesional. Neni 7 ka të bëjë me të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje (mosha minimale për punësim – 15 vjet, mbrojtje ndaj personave të cilët gjithnjë janë lëndë e arsimimit obligativ, për të mos u punësuar, në rast se kjo

⁴<https://www.right-to-education.org/page/united-nations-instruments>, qasur më 16.04.2020

do të ishte privim i tyre nga e drejta e arsimimit; sigurim i orarit të punës për personat nën 18 vjeç në përputhje me nevojat e zhvillimit të tyre, e sidomos me nevojën e tyre për trajnim profesional; trajtim të kohës së kaluar nga ana e personave të rinj në trajnim profesional gjatë orarit të zakonshëm të punës, me pajtimin e punëdhënësit, për t'u trajtuar si pjesë e ditës së punës). Neni 10 e regullon të drejtën e trajnimit profesional, ndërsa neni 15 ka të bëjë me të drejtën e personave me aftësi të veçanta, për pavarësi, integrim social dhe pjesëmarrje në jetën shoqërore, gjë që do të sigurohej nëpërmjet arsimimit dhe përgatitjes profesionale. Neni 17 flet për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve kundrejt mbrojtjes sociale, ligjore dhe ekonomike. Në fakt, me qëllim të sigurimit të realizimit efektiv të së drejtave të fëmijëve dhe të rinjve, të rriten në mjedis në të cilin inkurajon zhvillim të tërësishëm të personalitetit të tyre dhe kapaciteteve të tyre fizike dhe mentale, shtetet obligohen të ndërmarrin masa urgjente përkatëse, të dizajnuara mes tjerhash, për t'ju siguruar fëmijëve dhe të rinjve arsimim fillor dhe të mesëm falas, si dhe mbështetje për praninë e tyre të rregullt në shkollë.

- **Karta evropiane për gjuhët rajonale dhe të minoriteteve, viti 1992 (Neni 8)**

Sa i përket arsimimit, shtetet obligohen që në terroren të cilin përdoren këto gjuhë, pa e kundërshtuar mësimin në gjuhën zyrtare të shtetit, të mundësohet mësim në gjuhën rajonale apo të minoriteteve në arsimin fillor, të mesëm, profesional, teknik dhe në arimin universitar. Njëkohësisht, shtetet duhet të mundësojnë edhe kurse për të rriturit dhe edukim të vazhdueshëm ku kryesisht, apo tërësisht ligjërohet në gjuhë rajonale apo në gjuhën e minoriteteve. Me këtë rast, nevojitet të ndiqet përparimi dhe të përgatiten raporte periodike.

- **Konventa kornizë për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare, viti 1995 (Neni 12, Neni 13 dhe Neni 14)**

Me anë të kësaj Konvente shtetet ndërmarrin masa në fushën e arsimit dhe hulumtimit, në mënyrë që të inkurajohen njohuritë në fushën e kulturës, historisë, gjuhës dhe religjionit të minoriteteve të tyre kombëtare. Shtet duhet të sigurojnë mundësi përkatëse për trajnimin e mësuesve, qasje deri te librat dhe lehtësim të kontakteve ndërmjet nxënësve dhe mësimeve nga bashkësitë e ndryshme. Shtetet obligohen të promovojnë mundësi të barabarta për qasje në arsim deri te të gjitha nivelet, për personat që janë pjesë e minoriteteve kombëtare. Një tjetër e drejtë e shkruar është e drejta e që minoritetet kombëtare të mësojnë gjuhën e tyre amtare.

- **Konventa europiane për statusin juridik të punëtorëve migrant, viti 1977 (Neni 14)**

Në përputhje me Konventën e punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre, zyrarisht të parnuar në territorin e një shteti tjetër, kanë të drejtë, në bazë të njëjtë dhe në kushte të njëjta si punonjësit kombëtarë, në arsimim të përgjithshëm, trajnim profesional dhe parakualifikim, si dhe mundësi për qasje deri në arsimin e lartë, sipas rregullave të përgjithshme, me anë të së cilave sigurohet pranim në institucione të caktuara në shtet. Kjo Konventë parasheh edhe ligjërata në gjuhën amtare të migrantëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre, bursa për fëmijët e punëtorëve migrant, ndërsa arritjet paraprake sa i përket arsimimit (diplomave dhe kualifikimeve profesionale) të fituara në shtetin amë, do të pranohen në përputhje me marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale. Programet për përgatitje profesionale dhe parakualifikimet, duhet t'u përgjigjen nevojave të punëtorëve migrantë, me qëllim që të kthehen në vendin e tyre të origjinës.

- **Konventë për pranimin e kualifikimeve të arsimit të lartë në rajonin Evropian, viti 1997**

Këshilli Evropian në mënyrë periodike miraton rekomandime deri te vendet anëtare, sa i përket së drejtës të arsimimit. Këto rekomandime nuk janë obligative për vendet anëtare, por të njëjtat i shpien shtetet në zbatimin e politikave obligative. Rekomandime në lidhje me arsimimin, të dhëna nga Këshilli Evropian janë:

- ❖ Rekomandimi për sigurimin e arsimit cilësor, viti 2012
- ❖ Rekomandimi për arsimin e fëmijëve romë në Evropë, viti 2000
- ❖ Rekomandimi për arsimin e romëve dhe pasagjerëve në Evropë, viti 2009
- ❖ Rekomandim për përgjegjësinë publike për arsimin e lartë dhe hulumtimin, viti 2007
- ❖ Rekomandim për përfshirjen e aspekteve gjinore në vazhdimësi kryesore në kuadër të arsimit, viti 2007
- ❖ Rekomandim për Kartën e Këshillit të Evropës për arsim për shoqëri demokratike dhe
- ❖ Arsim për të drejtat e njeriut, viti 2010.

1.3 Standardet e UNESCO-s

Që nga formimi në vitin 1945, misioni i UNESCO-s (United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization) është që të kontribuojë në ndërtimin e paqes, zbutjen e varfërisë, zhvillim të përhershëm dhe dialog ndërkulturor, me anë të edukimit, si një ndër aktivitetet kryesore të saj, për arritjen e qëllimeve në fjalë. Aktivitetet tjera të Organizatës, përfshijnë shkencë natyrore, shkencat shoqërore dhe njerëzore, kulturën, komunikimin dhe informatat. Sot, UNESCO-ja synon vizionin holistik dhe humanitar, për arsim cilësor në tërë botën, sigurimin e së drejtës të arsimimit dhe besimi se arsimi luan rol fundamental në zhvillimin njerëzor, social dhe ekonomik.

Synimi apo përpjekja e UNESCO-s për të drejtën e arsimimit, përfshihet në tri dokumente kryesore për vendosjen e standardeve:

- ❖ E nënshkruar në vitin 1948, pas Luftës së Dytë Botërore, Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut (Neni 26), në të cilën thuhet se: „*Secili e ka të drejtën e arsimimit*“.
- ❖ Në vitin 1960, në kuadër të Konvendës kundër diskriminimit në arsim (Nenet 1,2,3,4 dhe 5) termi „diskriminim“ sqarohet si dallim, tërheqje, kufizim ose preferencë, e bazuar në racë, ngjyrë, gjini, gjuhë religjion, mendim politik, apo mendim tjetër, përkatësi sociale apo kombëtare, lindje apo gjendje ekonomike, e cila ka për qëllim efekt, pezullim apo prishje të nivelit të barazisë në arsim. Neni 2 i sqaron rastet të cilat nuk merren si diskriminim. Në përputhje me nenin 3, me qëllim të eliminimit dhe parandalimit të diskriminimit, vendet nënshkruese i ndërmarrin obligimet vijuese: t'i tërheqin dispozitat ligjore dhe dekretet administrative të cilat përfshijnë diskriminim në fushën e arsimit; me ligj, në rast se nevojitet, të sigurohet mos diskriminimi gjatë pranimi të nxënësve në kuadër të institucioneve të arsimit, të mos lejhoet, sa i përket taksave shkollore dhe ndarjes së bursave, apo formave tjera të ndihmës së nxënësve, të bëhen dallime në trajtim nga ana e autoriteteve publike, por edhe t'ju mundësohet shtetasve të huaj të cilët jetojnë në territorin e këtyre shteteve, qasje e njëjtë në arsim, njëlloj si që u është mundësuar shtetasve të vendit përkatës”. Neni 4 i obligon vendet anëtare të promovojnë barazi të mundësive dhe të trajtimit sa i përket arsimimit duke veçuar kushtet vijuese:

- (a) të vendoset që shkollimi fillor të jetë falas dhe i obligueshëm; shkollimi i mesëm në forma të ndryshme të jetë në dispozicion për të gjithë; ndërsa arsimi i lartë të jetë njëloj në dispozicion për të gjithë; në bazë të kapaciteteve individuale;
- (b) të sigurohet që standardet e arsimit të jenë ekuivalente në të gjitha institucionet publike arsimore në nivel të njëjtë dhe se kushtet në lidhje me arsimimin e siguruar të jenë gjithashtu ekuivalente;
- (c) të inkurajohet dhe të intervenohet me anë të metodave përkatëse arsimimi i personave të cilët nuk kanë shkollim fillor, ose të cilët nuk e kanë përfunduar shkollimin fillor, t'u mundësohet vazhdim i shkollimit në bazë të kapaciteteve individuale;
- (d) të sigurohet trajnim për profesionin e mësimdhënies pa diskriminim.

Neni 5 ka të bëjë me orientimin e arsimit kundrejt zhvillimit të tërësishëm të personalitetit njerëzor dhe fuqizimit të respektimit të së drejtave të dhe lirive themelore të njeriut, që promovojnë mirëkuptim, tolerancë dhe miqësi ndërmjet popujve, racave dhe grupeve fetare. Në përputhje me këtë nen, është tejet e rëndësishme të respektohet liria e prindërve dhe në rast se kjo do të ishte e realizueshme, përkujdesësve juridik, të cilët kanë të drejtë të zgjedhin arsimim religjioz dhe moral për fëmijët, në përputhje me bindjet persoanle. Është tejet e rëndësishme akseptimi i së drejtës së pjesëtarëve të minoriteteve kombëtare që të realizojnë aktivitetet e tyre edukative, duke përfshirë këtu edhe mirëmbajtjen e shkollave dhe varësisht nga politika arsimore e secilit shtet, të ndjekin shkollimin në gjuhën e tyre amtare, në rast se një gjë e tillë është e mundur dhe në rast se krijohen kushte përkatëse për të njëjtën.

❖ Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, viti 1989.

UNESCO është agjencia e vetme e Kombeve të Bashkuara me mandate t'i mbulojë të gjitha aspektet e arsimit. Puna e saj përfshinë zhvillimin e arsimit parashkollor, atij fillor, arsimin e mesëm dhe atë të lartë, duke përfshirë edhe arsimin teknik dhe atë profesional së bashku me trajnimin, arsimin joformal dhe arsimin e të rriturve. Orgaizata përqëndrohet në rritjen e nivelit të barazisë dhe qasjen, përmirsimin e cilësisë dhe sigurinë se arsimi zhvillon njohuri dhe shkathtësi në fusha siç janë zhvillimi i qëndrueshëm, HIV dhe AIDS, të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore. UNESCO-ja e koordinon lëvizjen “Arsimim për të gjithë”, ndjek

trendet e arsimit dhe i rrit programet për nevojat e arsimit të agjendave të zhvillimit global. UNSECO-ja është gjithashtu aktive dhe partnere e përkushtuar në kuadër të reformave të OKB-së, qëllimi i së cilës është avancimi i koordinimit, efikasitetit dhe prokurimit.

- ❖ Rekomandime: Rekomandimi për statusin e kuadrit mësimor të arsimit të lartë, viti 1997. Rekomandimi për pranimin e studimeve dhe kualifikimeve të arsimit të lartë, viti 1993; Rekomandimi për zhvillimin e arsimit të rriturve, viti 1976; Rekomandim për edukim dhe mirëkuptim ndërkombëtar, bashkëpunim paqe dhe edukim në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, viti 1974; Rekomandim për statusin e mësimdhënësve, viti 1966; Kornizë për arsimimin e nevojave të veçanta, viti 1994; Deklarata e Hamburut për arsimin e të rriturve, viti 1997; Korniza Aksionale e Dakarit – Arsimit për të gjithë: Realizim i përpjekjes tonë kolektive, viti 2000.

1.4 Standardet e Bashkimit Evropian

Në kuadër të Bashkimit Evropian, e drejta e arsimit është paraparë në nenin 14, në kuadër të Kartës për të drejtat themelore e cila hyri në fuqi më 18 dhjetor të vitit 2000 dhe atëduhet ta respektojë vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Sipas nenit 14 secili ka të drejtën e arsimit dhe qasje deri në trajnim profesional dhe të vazhdueshëm, ku kjo e drejtë e përfshinë mundësinë për të fituar arsim falas dhe obligativ. Në përputhje me nenin 14, respektohet liria për themelimin e institucioneve arsimore me respektim obligativ të parimeve demokratike dhe të drejtën e prindërve për të siguruar edukim dhe mësim për fëmijët e tyre në përputhje me bindjet e tyre fetare, filozofike dhe pedagogjike, në përputhje me ligjet kombëtare që e rregullojnë realizimin e lirisë dhe të drejtës së këtillë.

Neni 21, ka të bëjë me mosdiskriminimin. Në fakt, ndalohet secili lloj i diskriminimit i bazuar mbi çdo lloj diskriminimi për shkak të përkatësisë kombëtare.

Neni 32 ndalon punësimin e fëmijëve, ku mosha minimale për punësim nuk mund të jetë më e re nga mosha minimale nga dita e tërheqjes nga shkolla. Në përputhje me këtë nen, të rinjtë që pranohen në punë, duhet të kenë kushte për punë, që i përshtaten moshës së tyre dhe të jenë të mbrojtur nga eksploatimi ekonomik.

Në fakt, sa i përket Bashkimit Evropian, në kuptim më të gjerë, ai zhvilloi politika të arsimit që nga vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar me anë të krijimit të programit Erasmus nga viti 1987. Në rast se arsimimi megjithatë, mbetet në kompetenca të shteteve, Bashkimit Evropian i janë pranuar këto kompetenca përmes Marrëveshjes së Mاستrihtit e nënshkruar në vitin 1992. Prej asaj periudhe, BE-ja kryesisht është marrë me politikat e orientuara në ndërveprim të studentëve dhe profesorëve, si dhe në ndërveprim të arsimit profesional.

Kapitulli II

Implementimi i së drejtës së arsimimit

2.1. Organizimi dhe përmbajtja e arsimimit

Arsimimi është themeluar në bazë të historisë dhe nga ana e tij mund të dëshmojë dhe të themelojë historinë⁵. Fenomeni i arsimimit mund të ndiqet nga mendimtarët antik grek, e deri në kohën e sotme. Kjo problematikë nuk është aspak e thjeshtë, ajo lidhet me të mësuarit në të cilin do të interpretohej bota në të cilën jetojmë.

Arsimimi në kuptimin më të ngushtë, nënkupton process të marrjes së njohurive, ndërtimit të shkathtësive dhe shprehive, zhvillim të aftësive, miratim të sistemit, vlerave dhe rregullave të sjelljes. Në kuptimin më të gjerë, arsimimi paraqet proces të vazhdueshëm të realizimit të vlerave shpirtërore, proces i cili zgjatë gjatë tërë jetës. Karakteristikë esenciale e këtij procesi paraqet bashkërendimi dhe lidhja e arsimimit formal, joformal dhe informal në zhvillimin individual dhe formimit shpirtëror të secilit individ.

Arsimimi mund të jetë i përgjithshëm dhe profesional, institucional dhe jo institucional, i kohë pas kohshëm dhe permanent, etj. Termi bashkëkohor i arsimimit të njeriut e vë theksin në procesin e zhvillimit gjatë tërë jetës.

Arsimimi i individit nuk fillon me shkollim, por edhe nuk përfundon me atë. Arsimiti nënkupton punë në vete (vetëarsimim) dhe nuk mund të reduktohet në praktikë pedagogjike, e as në marrjen e roleve të caktuara në shoqëri. Kjo gjithsesi se nuk e redukton rëndësinë e arsimimit formal, pa të cilin nuk është e mundur që të rinjëve t'u transmetohet e gjithë ajo me të cilën disponon shoqëria. Ekzistimi i shkollës si institucion themelor i sistemit arsimor dhe të mësuarit si formë e punës në të, paraqesin transmetim të organizuar të njohurive dhe përvojave të vlerave jetësore. Gjatë kësaj, në punën e shkollës nuk ndikojnë vetëm karakteristikat personale të familjes dhe mjedisit shoqëror në të cilën janë të përfshirë edhe mësuesi edhe nxënësi. Arsimiti i cili përfitohet në shkollë, pasqyron bazën e arsimimit të përgjithshëm njerëzor dhe si proces i përfitimit dhe pasurimit të përvojave, por edhe si

⁵Slavka Gvozdenović: Filozofija, obrazovanje, nastava, Zavod za udžbenike i nastavna sredstva, Podgorica, 2005, str. 39–54

proces të rritjes dhe zhvillimit individual. Arsimi si pjesë e tërësisë marrëdhënies shoqërore dhe si mënyrë e ekzistimit të njerëzimit, nuk ka vetëm funksion social, por kjo para se gjithash, është dispozitë ekzistenciale e njeriut. Dimenzioni ekzistencial i arsimimit është i përfshirë në themelet ekzistenciale të individit dhe të bashkësisë.

Arsimimi është proces dhe rezultat, mundësi për avancim dhe zhvillim në planin individual. Sipas dedikimit, mund të jetë i dedikuar - në përgjithësi, për të gjithë dhe ka të bëjë me njohuritë, shkathtësitë dhe shprehjet, të cilat ndihmojnë në gjindshmërinë ndaj kushteve të caktuara shoqërore dhe të jetesës, duke ofruar mirëkuptim për botën në të cilën jetojmë dhe mund të jetë në funksion – të veprimtarisë profesionale që ka të bëjë me njohuri dhe shkathtësi të nevojshme për punë në çdo sferë.

Arsimi formal realizohet në institucione të ndryshme arsimore dhe përfundon me fitimin e kualifikimeve dhe diplomave të pranuar. Sipas nivelit, mund të jetë fillor, i mesëm dhe i lartë. Sipas moshës – parashkollor, shkollor dhe arsim për të rritur. Këtu dallojnë dy anë – mësimdhënës të cilët e marrin përgjegjësinë për arsimimin e nxënësve.⁶ Mësimi është i institucionalizuar dhe e organizuar në mënyrë simultane sipas plan programit mësimor të definuar paraprakisht (dokumenti bazë të cilin janë përmendur lëndët mësimore mësohen gjatë periudhës një vjeçare, përfshirë këtu edhe numrin e orëve të mësimi) dhe programit (përmbajtjet e paraqitura arsimore të cilat duhet të realizohen në nivel përkatës me të cilin përcaktohet intenziteti dhe ekstenziteti i të mësuarit të përmbajtjes së ndonjë lënde). Qëllimi i mësimi është që përmes përmbajtjeve të përshkruara dhe përfitimit të njohurive, shkathtësisve dhe shprehjeve, aftësimi për punë të mëtejme permanente, me qëllim të zhvillimit të qenies së lirë, kritike, autonome, krijuese, humane, të përgjegjshme, multikulturore dhe multietnike, të hapur për të gjitha ndryshimet aktuale dhe vijuese progresive të individit dhe të shoqërisë në të cilën bën pjesë.

Lloj tjetër i arsimimit është arsimimi joformal i cili i përfshin të gjitha format e përfitimit të njohurive dhe shkathtësisve, të cilat nuk janë tërësisht të domosdoshme, të cilat nuk përfshinë forma formale të arsimimit dhe praktikimi dhe miratimi i të cilit varet nga secili individ veç e veç⁷. Bëhet fjalë për aktivitet të organizuar dhe sistematik, i orientuar

⁶Langford, Glenn & O'Connor D. J. (izdavači), New Essays in the Philosophy of Education, Routledge & Kegan Paul Ltd., London, 1973

⁷ Kuka, E. (2010.) Imperativ prosperiteta. Sarajevo: KNS-Udruženje za kulturu Novo Sarajevo

nëdrejtim të shkathtësimit për punë, aktivitete sociale dhe jetë private⁸. Përmbajtja më e rëndësishme e arsimimit joformal dhe sigurisht arsya kryesore për tërheqje të këtij lloji të arsimimit, është fakti që ai mund të zhvillohet në mënyrë vullnetare dhe jashtëinstitucioneve .

Arsimimi joformal përfshin forma të ndryshme të përfitimit të njohurive, të cilat përfshijnë forma vetëiniciuese apo forma spontane të arsimimit, të a.q. format spontane të transferimit të njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve.

Të tri format e lartëcekura të arsimimit, së bashku formojnë një tërësi homogjene të quajtur koncept i të mësuarit përgjatë gjithë jetës.

Për organizimin e programeve arsimore dhe lidhjen e tyre me kualifikimet sipas niveleve dhe fushave, përdoret Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (ISCED) i cili mundëson grumbullimin, krahasimin dhe analizën e të dhënave në nivel ndërkombëtar. Bëhet fjalë për prodhim me anë të bashkërendimit apo marrëveshjes ndërkombëtare, formalisht e miratuar në kuadër të Konferencës së Përgjithshme të Vendeve Anëtare të UNSCO-s.

Për implementimin e të drejtës së arsimimit, për strukturën dhe për përmbajtjen e tij, janë përgjegjëse shtetet përmes krijimit të ligjeve, parimeve dhe praktikave. Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, vetëdija për rëndësinë e qasjes për njohuritë, për zhvillimin e ekonomisë, pa dyshim që e inkurajon zhvillimin e qasjeve edhe për arsimimin për më të rinjtë në vendet në fazë të rimëkëmbjes apo të mëvetësimit. Kjo është edhe arsya, pse Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore rregullon të drejtën e arsimimit në të gjitha aspektet e tij.

Por fatkeqësisht, për këtë shkak, arsimimi anashkalohet me dekada dhe bashkësia ndërkombëtare konstaton se për miliona njerëz në tërë botën, shfrytëzimi i të drejtës së arsimimit është një qëllim i paarrtshëm.

2.2. Sanksionimi i të drejtës së arsimimit

Sipas hulumtimit ndërkombëtar të zhvilluar në 40 vende, në vitin 2012, sa i përket së drejtës së arsimimit, janë fituar rezultatet vijuese⁹:

⁸ Kulić, R. / Despotović, M. (2005.) Uvod u andragogiju. Zenica: Dom štampe Zenica

- Rreth 124 milionë fëmijë të moshës prej 6-5 vjeç ose asnjëherë nuk kanë shkuar në shkollë, ose kanë hequr dorë, përkundër 122 milionë të tillë në vitin 2011.
- Fëmijët e moshës prej 12-15 vjeç të cilët është dashur të jenë pjesë e arsimit tëmesëmështë pothuajse dyfish më i besueshëm, se sa fakti për të qenë jashtë bankave shkollore, në krahasim me fëmijët e shkollave fillore.
- Rreth 31 milionë vajza në tërë botën nuk ndjekin shkollën fillore.
- Rreth 34 milionë vajza abstenojnë nga ndjekja e mësimi në shkollë të mesme.
- Rreth 24 milion vajza ndoshta nuk do të shkojnë në shkollë.
- Rreth 29 milion fëmijë nuk shkojnë në shkollë për shkak të konfliktit apo shpërnguljes, duke përfshirë këtu edhe „gjeneratën e humbur“ të fëmijëve sirianë, 2,1 nga të cilët nuk vijojnë mësim në Siri, ndërsa pothuajse 1 milion prej tyre jetojnë si refugjatë në vendet fqinje.
- Me miliona fëmijë, në vendet ku mbretëron gjendje e jashtëzakonshme – si në Republikën e Afrikës Qëndrore, Nigeri dhe në Sudanin Jugor e kanë përgjysmuar apo u është cënuar e drejta e shkollimit. Shumica janë të gatshëm të luftojnë si ushtarë, apo janë të detyruar t'i përkrahin grupet e armatosura.
- Disa popuj janë në gjendeje të palakmueshme, duke përfshirë këtu edhe 93 milionë fëmijë nën moshën 14 vjeçare, për të cilët Organizata Botërore e Shëndetsisë në vitin 2011 ka vlerësuar se kanë invaliditet të pjesërishtëm apo të rëndë – një numër i panjohur i tyre nuk vijojnë shkollimin e rregullt.

Të dhënat e UNESCO-s janë pothuajse tmerruese, sipas të cilave¹⁰:

- ❖ 750 milionë fëmijë dhe të rinj gjithnjë nuk dinë të lexojnë dhe të shkruajnë,
- ❖ 262 milionë fëmijë dhe të rinj janë jashtë bankave shkollore, aty ku duhet të jenë,
- ❖ 1 nga 11 fëmijë nuk vijon shkollimin fillor,
- ❖ 1 nga 5 adoleshentë e ka braktisur shkollën e mesme,
- ❖ më shumë se 1 apo 2 fëmijë të moshës për shkollim fillor, nuk e ka arritur nivelin minimal të standardeve për cilësi gjatë leximit.

⁹<https://www.hrw.org/report/2016/06/09/education-deficit/failures-protect-and-fulfill-right-education-through-global>, qasur më 29.04.2020

¹⁰<https://en.unesco.org/news/what-you-need-know-about-right-education>, qasur më 29.04.2020

Mekanizmat e dobëta qeveritare për mbikqyrje, mungesa e politikave për nulta diskriminim, mungesa e përgjegjësisë për fëmijët të cilët heqin dorë nga arsimimi dhe nga fuqia e pakontrolluar që e posedojnë personat zyrtarë në kuadër të shkollave për atë që shkon në shkollë dhe për atë që ngelet jashtë, janë disa ndërfaktorët që kontribuojnë në dështimin e qeverive, për të siguruar të drejtën e arsimimit cilësor për fëmijët të cilët tradicionalisht janë të diskriminuar.

Përveç kësaj, trysnia globale për arsim fillor të obligueshëm përmes agjendave zhvillimore, në disa raste, në mënyrë të paqëllimshme solli deri te vëmendja më e vogël politike dhe financiare të së drejtës së arsimimit të mesëm, gjë që rezultoi me miliona adoleshentë të cilët nuk kishin mundësi të vazhdojnë shkollimin e tyre. Raporti i lartëcekur, flet për atë se kemi të bëjmë me fëmijë dhe adoleshentë të cilët janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të mëdha nga eksploatimi i shtesës fëmijërore, martesës së hershme, apo shtatzënisë të adoleshentët, si dhe femra dhe të rinj me pengesa në zhvillim, gjasa e të cilëve, për të fituar të drejtën e shkollimit të mesëm, tashmë është e kufizuar me anë të pengesave diskriminuese sistematike¹¹.

E drejta e arsimimit garantohet përmes dy mënyrave – përmes instrumenteve ndërkombëtare normative dhe përmes vendimeve politike të qeverive. Ekziston kornizë e fuqishme ndërkombëtare të konventave dhe marrëveshjeve për mbrojtjen e së drejtave të arsimimit dhe shtetet kombëtare të cilat i kanë ratifikuar instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, janë të obliguara, pa marrë parasysh faktit se cila qeveri është në pushtet, të veprojnë në përputhje me të drejtat e mishëruara me ato instrumente. Shtetet e kanë përgjegjësinë kryesore dhe përgjigjen para bartësve të së drejtave për implementin e të njejtave. Në mënyrë që të sigurohet realizimi i së drejtës së arsimimit, shtetet ndajnë tri nivele të përgjegjësisë¹²:

- **Të përmbushin të drejtën e arsimimit** përmes sigurimit të qasjes në arsim për të gjithë, duke ndërmarrë masa pozitive në mënyrë që t'u mundësohet fëmijëve përfitim nga ky proces, për shembull, në përpjekjet për ballafaqim me varfërinë, përshtatjes së programit mësimor për nevojat e të gjithë fëmijëve apo angazhimit të prindërve për

¹¹ Ибид.

¹² Committee on Economic, Social and Cultural Rights, 'General Comment No. 13: The right to education (article 13)', E/C.12/1999/10, December 1999, paras. 43, 44, 50.

t'u mundësuar që ata të jenë mbështetje efikase në kuadër të arsimimit të fëmijëve të tyre.

- **Të respektojnë të drejtën e arsimimit** me anë të shmangjes së çfardo aksioni që do të shërbejë në parandalimin e qasjes së fëmijëve deri te procesi i arsimimit, për shembull, ligjvënia që karakterizon një grup të caktuar të fëmijëve me aftësi të veçanta, si persona të cilët janë të anashkaluar nga procesi i arsimimit.
- **Të mbrojnë të drejtën e arsimimit** me anë të marrjes së masave të panevojshme për heqjen e barierrave në kuadër të arsimimit të vendësorë nga ana e individëve apo bashkësive të caktuara, për shembull barierrat kulturore, apo keqpërdorimit dhe dhunës në kuadër të mjediseve shkollore.

Në mënyrë që të përmbushen këto tre kushte në raport me të drejtën e qasjes në arsimim, është jashtëzakonisht i rëndësishëm mjedisi politik dhe ai ekonomik, korniza ligjvënëse dhe politikat arsimore tështeteve .

Përpos kontrollit shtetëror ndaj së drejtës së arsimimit, këtë e bën edhe UNESCO-ja. Në fakt, UNESCO-ja zhvillon, ndjek dhe promovon norma dhe standarde të arsimimit të cilat e garantojnë të drejtën e arsimimit në nivel shtetëror. Shtetet i posedojnë të drejtat juridike të cilat reflektojnë mbi konvizat kombëtare juridike dhe të njejtat i shëndrrojnë në politika konkrete. Për këtë qëllim, UNESCO-ja përmes trupave të tij, realizon¹³:

- ✓ ndjekjen e zbatimit të së drejtës së arsimimit në nivel shtetëror
- ✓ mbështetje ndaj shteteve, të vendosin korniza të fuqishme shtetërore kombëtare, duke krijuar bazë juridike dhe kushte për arsimim cilësor për të gjithë
- ✓ përfaqësimi i së drejtës së parimeve të arsimimit dhe obligime juridike përmes hulumtimeve dhe studimeve të çështjeve kyçe
- ✓ ndjekja e opservimit global për të drejtën e arsimimit
- ✓ fuqizimi i kapaciteteve, mekanizmave, raportimi dhe vetëdija për sfidat kyçe
- ✓ zhvillim i partnereiteteve dhe masave rreth problemeve kyçe.

Çfarë do të ndodhë në rast se shtetet nuk i përmbushin obligimet sa i përket të drejtës së arsimimit? Në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe komëbtar, ekzistojnë mekanizma për

¹³<https://en.unesco.org/news/what-you-need-know-about-right-education>, qasur më 23.04.2020

të drejtat e njeriut, që e ndjekin realizimin e së drejtës së arsimimit dhe mund të raportojnë për cënimin e së drejtës së arsimimit, apo për zbarzëirat në zbatimin e saj.

Instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kanë vendosur kornizë të fuqishme normative për të drejtën e arsimimit. Kjo nuk ka të bëjë me ndonjë deklaratë boshe, për të arritur ndonjë qëllim, sepse dispozitat e saj janë juridikisht të obligueshme. Të gjitha vendet e botës kanë ratifikuar të paktën një marrëveshje e cila përshinë aspekte të caktuara të së drejtës së arsimimit. Kjo do të thotë se të gjitha shtetet merren si përgjegjëse, përmes mekanizmave boshe të cilat u nënshtrohen ligjeve të së drejtës ndërkombëtare. Realizimi i së drejtës së arsimimit në nivel ndërkombëtar bëhet nëpërmjet mekanizmave të ndryshme për të drejtat e njeriut të cilat janë kompetente të përgjigjen ndaj ankesave individuale dhe në këtë mënyrë të vërtetojnë cënimin e së drejtës së arsimimit. Aty ku është cënuar e drejta e arsimimit, qytetarët duhet të kenë mundësi për procedurë juridike para gjyqeve dhe ligjit, ose para tribunaleve administrative. Mekanizmat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ku mund të paraqitet cënimi i së drejtës së arsimimit janë:

- ✓ Trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara: Komisioni për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESCR), Komisioni i të Drejtave të Fëmijëve (CRC), Komisioni për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË), Komisioni për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD), Komisioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Veçanta (CRPD), Komisioni për Punëtorët Migrantë (HRC);
- ✓ Këshilli i të Drejtave të Njeriut;
- ✓ Raportuesi Special i OKB-së;
- ✓ Komiteti për Konvencione dhe Rekomandime të UNESCO-s.

Për vendet të cilat nuk i plotësojnë këto obligime në lidhje me të drejtat, në mesin e tyre edhe të drejtën e arsimimit, zbatohen masa ndërkombëtare të kufizimit (sansione) të cilat paraqesin njërin ndër instrumentet me të cilat insistohet të ndryshohen aktivitetet të caktuara apo politika të shtetit me të cilat nuk respektohet sundimi i së drejtës.

2.3. Normativi për të drejtën e arsimimit: procedurat dhe masat e ndjekjes

E drejta e arsimimit ka të bëjë me obligimin e shteteve nënshkruese të marrëveshjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të krijojnë kushte optimale, gjegjësisht t'i shmangin të gjitha pengesat, në mënyrë se çdo fëmijë dhe secili person i rritur, përmes edukimit dhe arsimimit t'i zhvillojë mundësitë e tij natyrore dhe në këtë mënyrë të krijojë pavërsi kognitive dhe sociale.

Në mënyrë që të njihen të gjitha, po edhe mënyrat më subtile të cënimit të së drejtës së arsimimit, nuk mjafton të njohim vetëm definicionin e kësaj të drejte, por edhe kornizën teorike e cila në mënyrë precize do të sqarojë se çfarëpërfshin ajo e drejtë dhe cila në një rreth më të gjerë të përdoruesve, do t'u ndihmojë në identifikimin e thjeshtë të cënimit të kësaj të drejte në praktikë. Një lloj kornize të këtillë juridike është krijuar nga ana e Katerina Tomashevski, raportuesja e parë speciale e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e arsimimit. Kjo kornizë flet për katër dimensionet e së drejtës së arsimimit: disponueshmëri, dispozicion, pranueshmëri dhe përshtatshmëri¹⁴.

Disponueshmëria e arsimimit nënkupton oblim të shtetit të formojë dhe të financojë institucionet arsimore me qëllim të sigurimit të edukimit për të gjithë, por edhe obligim për të siguruar ndarësitë e nevojshme buxhetore dhe resurset material e njerëzore, në mënyrë që edhe personat privat dhe juridik të mund në mënyrë të pavarur të themelojnë institucione të arsimit. Disponueshmëria, sipas kësaj, ka të bëjë me sigurimin e sa më shumë institucioneve arsimore, sidomos të institucioneve të arsimit fillor, të cilat duhet të jenë falas dhe obligativ.

Dispozicioni në arsimim ka të bëjë me obligimin e shtetit të sigurojë arsimim fillor falas dhe obligativ për të gjithë, ndërsa arsimi i mesëm dhe ai i lartë, në kushte të caktuara, që përfshin identifikimin dhe shmangjen e të gjitha barrierave të cilat shpiejnë drejt diskriminimit dhe eliminimin e personave në bazë të gjinisë, gjuhës, mjeteve financiare, përkatësisë etnike dhe karakteristikave tjera tjera. Dispozicioni, sipas kësaj nënkupton afërsi fizike deri te institucionet arsimore, apo qasje përmes teknologjive bashkëkohore dhe dinemsonit ekonomik që përfshin çmime të arsyshe të librave dhe materialeve tejra, transportin publik të nxënësve, si dhe dimensionin mos diskriminues, gjegjësisht arsimimin

¹⁴Tomaševski, K. (2006) Human rights obligations in education: The 4-A Scheme. Nijmegen: Wolf Legal Publishers.

që nuk është nën tryshinë e praktikave diskriminuese, e që është në dispozicion për të gjithë, sidomos për grupet më të prekura sociale.

Pranueshmëria e arsimit ka të bëjë me obligimin e shtetit për të siguruar sipas standardeve të caktuara, të a.q. cilësi të caktuara. Kjo përfshin përzgjedhje falas të arsimit, përmbajtje dhe programe cilësore, si dhe metoda përkatëse për mësim dhe vlerësim. Përveç kësaj, pranueshmëria do të thotë që të drejtat e njeriut të të gjithë përfshirëve janë të promovuar në fushën e arsimit dhe se disiplina në shkollë dhe në klasë zbatohet në tërësi.

Përshtatshmëria ka të bëjë me obligimin e shtetit për të përshtatur arsimimin ndaj grupeve të ndryshme të fëmijëve dhe të rinjve, siç janë pjesëtarët e minoriteteve, fëmijët me nevojë të veçanta, fëmijët refugjatë, etj, ndërsa fëmijët t'i përshtaten shkollës, gjë që për fat të keq është një situatë e zakonshme në praktikë.

Vetëdijshmëria për të drejtën e arsimit dhe çfarë nënkupton apo paraqet hap i parë i tejkalimit të problemeve që kanë të bëjnë me këtë të drejtë.

E drejta e arsimit - në përputhje me parimet për të drejtat e njeriut, duhet të jetë prezente në kuadër të kornizës ligjvënëse. Kjo duhet pranuar publikisht, si e drejtë për të cilën është përgjegjëse qeveria e vendit, e drejtë të cilën individët mund ta kërkojnë dhe në qoftë se ka nevojë, ta zbatojnë me anë të gjyqësorit. Ligjvënja e këtillë jo vetëm që duhet t'i ketë parasysh obligimet ndërkombëtare të cilat shteti përkatës i ka në raport me realizimin e asaj të drejte sipas inkorporimit në të drejtën vendore, por gjithashtu duhet të merret edhe me heqjen e barrierave direkte dhe indirekte të cilat e parandalojnë qasjen. Nevojiten normativa të veçanta dhe masa ligjvënëse të cilat do të variojnë varësisht kontekstit të ndryshëm të shtetit, por ato njëkohësisht duhet të përshijnë¹⁵:

- *Arsimimi si e drejta e të gjithë fëmijëve*: ligjvënja duhet të sigurojë të drejtë për të gjithë fëmijët për arsim fillor obligativ. Në disa vende, kjo është e paraparë me Kushtetutë, ndërsa aty ku është paraparë, mund të bëhen edhe ndryshime kushtetuese. Për shembull, në Indi, Kushtetuta është e ndryshuar dhe e plotësuar përmes ndryshimit të 93-të kushtetues, me qëllim që të sigurohet shkollim fillor falas dhe obligativ, për të gjithë duke filluar nga moshë 6-14

¹⁵ UNICEF, A Human Rights-Based Approach to EDUCATION FOR ALL, 2007, достапно на: https://www.unicef.org/publications/files/A_Human_Rights_Based_Approach_to_Education_for_All.pdf, qasur më 18.04.2020

vjeç¹⁶. Por, në vitin 2004, është konstatuar se në më së paku 25 vende, gjithnjë nuk specifikohet mosha për arsimim obligativ¹⁷. Gjithashtu, shtetet duhet të kenë parasysh edhe inkudrimin e së drejtës së arsimit të mesëm si qëllim afatgjatë.

- *Eliminimi i diskriminimit*: shtetet duhet të shqyrtojnë ligjvënien ekzistuese, në mënyrë që të sigurohen që nuk ekziston diskriminimi i drejtpërdrejtë apo indirekt në kuadër të normativit dhe ligjeve të cilat do ta pengonin të drejtën e arsimimit për të gjithë fëmijët. Veprimtaria ligjvënëse për mbrojtjen e fëmijëve në fjalë, të cënuar dhe të prekur nga diskriminimi, duhet të përfshijë: gjininë, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijë nga minoritetet etnike, fëmijë nga institucionet, fëmijë të cilët janë shtatzënë apo tashmë janë prindër, fëmijë me mangësi specifike shëndetësore apo me problem të kufizimit.
- *Standarde minimale*: Duhet të vërtetohen nivelet minimale të klasifikimit për mësimdhënësit në të gjitha nivelet e sistemit arsimor dhe standardet e njejta të zbatohen në shkollat e mjediseve urbane dhe mjediseve rurale. Duhet të definohet orari i plotë i punës sa i përket numrit të orëve specifike në javë dhe në vit, si dhe të rregullohet apo vërtetohet numri minimal i pjesëmarrësve për një mësimdhënës. Mund të jetë e dobishme edhe përfshirja e anëtarëve të bashkësisë lokale në trupat drejtues, në mënyrë që të fuqizohet mbështetja dhe në mënyrë që të promovohet përgjegjësia dhe transparenca.
- *Interesi më i mirë për fëmijën*: Parimi sipas të cilit intereset më të mira për fëmijët duhet të jenë primare në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me të, duhet të jenë të përfshira në të gjitha ligjvëniet relevante, duke përfshirë këtu edhe ligjet e arsimit.
- *Kornizë inkluzive*: Ligjvënien e cila vendos ndalesa për politika, praktika dhe për procedurat të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo në mënyrë indirekte i diskriminojnë personat me nevoja të veçanta, nuk do të jenë të mjaftueshme për t'i dhënë fund të gjitha formave të përjashtimit apo segregacionit. Për

¹⁶ United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization, EFA Global Monitoring Report 2002: Is the world on track?, UNESCO, Paris, 2002, p. 106.

¹⁷ Melchiorre Angela, At What age?...are school children employed, married and taken to court?, 2nd ed., Right to Education Project, Lund, 2004, p. 5

shembull, sisteme të veçanta të shkollimit për fëmijët me nevoja të veçanta, shpesh herë i hasim, apo të njëjtat mbahen, pa cënuar ligjet mosdiskriminuese. Nevojitet të vazhdohet më tutje dhe të vendoset obligim pozitiv për promovimin e mjediseve inkluzive arsimore.

- *Eliminimi i punës së fëmijëve*: Eliminimi i mundit të fëmijëve paraqet parakusht për realizimin e së drejtës së fëmijëve për t'u arsimuar. Dëshmitë thonë se fëmijët punëtorë edhe kur ata shkojnë në shkollë, kanë tendencë për të arritur rezultate më të dobëta në kuadër të mësimin, në krahasim me fëmijët që nuk mundohen dhe nuk punojnë¹⁸. Shumë vende momentalisht nuk ia dalin të sinkronizojnë sistemin e tyre ligjvënës, sa i përket moshës minimale për orarë të plotë të punës, si dhe moshës së largimit nga shkolla, në përputhje me Konventën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹⁹. Ligjet duhet t'i mbrojnë fëmijët nga përdorimi i tyre në forma të rrezikshme dhe të dëmshme të punës dhe t'i afrojnë shtetet në përputhje me Standardet e Konventës të të Drejtave të Fëmijëve (neni 32) dhe konventave relevante të Organizatës Ndërkombëtare të Punës²⁰.
- *Regjistrimi i të posalindurve*: për shumë fëmijë, mungesa e certifikatës së lindjes nga libri amë i të lindurve rezulton me pamundësi për të vijuar shkollën. Edhe përkundër obligimit të qartë në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve që të bëhet regjistrimi gjatë lindjes, në vitin 2003 kanë mbetur pa u regjistruar mbi 50 milionë lindje në botë – 36% nga të gjitha lindjet gjatë atij viti²¹. Mungesa e dokumentacionit prindëror, pamundësia për të paguar taksat, mungesa e qasjes deri në sistemin e regjistrimit, analfabetizmi i prindërve, si dhe mungesa e mirëkuptimit për rëndësinë e marrjes së certifikatës së lindjes, ka kontribuar deri në dështim për të regjistruar fëmijët e posalindur. Përveç ligjvënies, në këtë proces duhet të përfshihen edhe strategji tjera të ndryshme

¹⁸ Sakurai, Riho, 'Child Labour and Education', background paper prepared for the Education for All Global Monitoring Report 2007, United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization, 2006, p. 28.

¹⁹ Melchiorre Angela, *At What age?...are school children employed, married and taken to court?*, 2nd ed., Right to Education Project, Lund, 2004, p. 5.

²⁰ United Nations Convention on the Rights of the Child, article 32; and International Labour Organization Convention 182.

²¹ United Nations Children's Fund, *The 'Rights' Start to Life: A statistical analysis of birth registration*, UNICEF, New York, 2005, pp. 3–4.

të cilat do të kontribuojnë për rritjen e për qindjes së regjistrimit të posalindurve, siç janë reduktimi i taksave për regjistrim, ose thjeshtësimi i procedurave të regjistrimit. Shembull për një kampanjë të këtillë mund të jetë edhe vendosja e regjistërve mobil në mjediset rurale në Kolumbi, ku është i identifikuar nivel i ulët i regjistrimit të të posalindurve.

- *E drejta e participimit*: e drejta e fëmijëve për të shprehur qëndrimet e tyre dhe dhënia e peshës përkatëse sa i përket respektimit të nivelit të arsimit të tyre, asnjëherë nuk do të realizohet në tërësi pa vendosje të kornizës ligjore. Duhet të vendsoet ligjvëniet që kërkon nëpër shkolla të formohen trupa demokratikë të udhëhequr nga vet nxënësit, siç janë këshillat e shkollave, përmes të cilave ata do të mund t'i përfaqësojnë intereset e tyre. Kjo është realizuar, për shembull në disa vende europiane dhe në vende të Amerikës Jugore.
- *Ndalesë e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve*: Nevojitet ligjvëniet me anë të së cilës do të ndaloheshin të gjitha format e ndëstimit fizik dhe atij nënçmues të fëmijëve nëpër shkollat²². Duhet t'u vihet fund të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve, përfshirë këtu edhe dhunën në shtëpi, në mënyrë që të sigurohen mekanizma efektivë për ankesa nga ana e fëmijëve kur nuk respektohet ligji²³. Raporti botëror për dhunën ndaj fëmijëve jep rekomandime të detajizuara për aksion dhe për atë se si do të ishte parandaluar dhuna ndaj fëmijëve nëpër shkollat²⁴.

E drejta e arsimit, në planin ndërkombëtar monitorohet dhe matet në mënyra të ndryshme. Kushtetuta e UNESCO-s kërkon nga vendet anëtare që rregullisht të raportojnë në lidhje me masat për zbatimin e instrumenteve për vendosjen e standardeve në nivel vendi, përmes konsultimeve të rregullta. Përmes bashkëpunimit me trupat për të drejtat e njeriut të OKB-së, UNESCO-ja jep rekomandime deri te shtetet për përmirsimin e situatës në aspektin e të drejtës së arsimit në nivel kombëtar. Nëpërmje përdorimit të observatorit dedikues

²²For detailed information on action to end physical punishment, see Harper, Kate, et al., *Ending Physical and Humiliating Punishment of Children: Manual for Action*, Save the Children Sweden/International Save the Children Alliance, Stockholm, 2005.

²³ Pinheiro, Paulo Sérgio, *The World Report on Violence Against Children*, Report by the Independent Expert for the United Nations Secretary-General's Study on Violence against Children, Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, United Nations Children's Fund and the World Health Organization. Geneva, 2006, pp. 18, 21.

²⁴Ибид.

të obline rrjetit, UNESCO-ja bën analizë të zbatimit të së drejtës së arsimit në 195 vendet anëtare. Në bazë të mbikqyrjes, UNESCO-ja vendeve anëtare të saj, u ofron ndihmë teknike dhe këshilla për politikën me ndihmën e të cilave dëshirojnë t'i rishqyrtojnë, zhvillojnë, avancojnë dhe reformojnë kornizat vetanake juridike dhe vetanake. Trupat e OKB-së e mbykqyrin dhe e ndjekin zbatimin e dispozitave ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe zbatimin e së drejtës së arsimit, përmes katër funksioneve kryesore ²⁵:

- (a) shqyrtim të raporteve periodike të publikuara nga ana e shteteve;
- (b) sqarim dhe interpretim të veprimit relevant përmes miratimit apo aprovimit të komenteve të përgjithshme;
- (c) shqyrtim të ankesave (vetëm kur do të harxhohen të gjitha zgjidhjet e mundshme juridike);
- (d) hetime në lidhje me kundërvajtje serioze apo sistematike.

Komitetet shqyrtimin e tyre e bazojnë në dialog interaktiv me shtetin dhe me informatat e marra nga ana e trupave tjerë/ agjencive të OKB-së, si dhe përmes raporteve „nën hije“ të cilat merren si mjaft serioze, më shpesh për shkak të dhënies së dëshmimeve të fuqishme, rreth asaj se si shteti i ndjek apo nuk i ndjek obligimet e tij.

Pas marrjes së raporteve, trupat mbajnë mbledhje. Ato formojnë një listë të pyetjeve për të cilat shteti përgatit përgjigje me shkrim, zhvillohet dialog konstruktiv me shtetin (mund të përfshihen edhe organizatat joqeveritare), ku më pas trupi jep konkluzat e fundit. Këto pikëpamje konkuzive i theksojnë edhe mënyrat pozitive me të cilat shteti e zbaton marrëveshjen dhe fushat e veprimit, me anë të disa rekomandimeve. Vlen të theksohet se trupat pranë OKB-së, janë përgjegjëse të zbatojnë raportet që vijnë vetëm nga shtetet që e kanë ratifikuar marrëveshjen përkatëse. Pas dhënies së rekomandimeve, fillon procedura për ndjekjen e tyre.

Raportuesi special i OKB-së për të drejtën e arsimit, ka mandate për të vlerësuar situatën e të drejtës së arsimit në tërë botën. Përmes raporteve tematike për shtetin, raportuesi special, jo vetëm që e hulumton dhe ndjek zbatimin e së drejtës së arsimit, por ai njëkohësisht edhe e orienton mirëkuptimin drjet aspekteve kyçe dhe jep rekomandime për aktivitetet e mëtejme. Raportuesi special mund të pranojë ankesa individuale për cënimin e të

²⁵<https://www.right-to-education.org/page/report>, qasur më 24.04.2020

drejtës së arsimimit. Deri në kufirin e resurseve që ai i ka në dispozicion, ai/ajo i drejtohet qeverisë përkatëse, duke e thirrur për koment në lidhje me qëndrimet, kërkon sqarime shtesë, duke e rikujtuar qeverinë për obligimet e saj sipas së drejtës ndërkombëtare dhe kërkon informata, në qoftë se ka hapësirë të përshtatshme, për hapat e ndërmara nga ana e autoriteteve, për zgjidhjen e situatës përkatëse. Raportuesi special ifton të gjithë palët shtetërore, që të reagojnë në mënyrë të menjëhershme ndaj komunikimit të tij/saj, në mënyrë që të ndërmerren të gjitha hapat e nevojshme, për përmirësimin e situatave të cilët përfshijnë cënimin e së drejtës së arsimimit. Komunikimi nga ana e raportuesit special deri te qeveria në fazën e parë, është konfidencial, deri në rezimenë e letrave që i konvenojnë qeverisë për të mos qenë të përfshira në shtesën e 1 nga raporti vjetor dërguar deri te Këshilli i të Drejtave të Njeriut.

Sistemet rajonale për të drejtat e njeriut, gjithashtu sigurojnë mekanizma për ndjekjen e të drejtës së arsimimit. Funksionet e tyre janë të ngjajshme me ekuivalencat ndërkombëtare, duke përfshirë këtu shqyrtimin e raporteve periodike, analizën e ankesave individuale dhe interpretimin e dispozitave të dala nga marrëveshjet.

Në nivel kombëtar, shpesh herë ka trupa për të drejtat e njeriut, ku mund të paraqesim cënimin e së drejtës së arsimimit, siç janë institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut apo obdusmanët. Këto trupa kanë mision të promovojnë dhe të mbrojnë të drejtat e njeriut në terren nikoqir. Ata janë të financuara nga shteti dhe së bashku me qeverinë, punojnë për të qenë të sigurt se ligjet dhe politikat janë në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ata gjithashtu mund të zbatojnë dhe të analizojnë ankesat individuale. Obdusmani është personalitet i pavarur i cili shërben si ndërmjetsues ndërmjet shtetit dhe shoqërisë qytetare. Obdusmani mund të pranojë dhe të analizojë ankesa individuale dhe të japë rekomandime, apo të lehtësojë ndërmjetësimin. Ndonjëherë mund t'i identifikojë trendet dhe problemet sistematike që kanë të bëjnë me shërbimet e publike jo të mirëfillta, apo cënimin e së drejtës. Në disa vende, mund të ketë obdusman i cili ka mandat specifik apo më të kufizuar, si që është obdusmani për fëmijë. Gjithashtu, mund të ketë obdusman për çështjen e fushës së arsimit.

Në nivel lokal, mund të ketë këshilla shkollor apo komitete shkollorë për drejtim, me të cilat mund të kontaktohet në rast të ndonjë ankese sa i përket të drejtës së arsimimit. Shpeshherë, është më mirë të nisim kontaktin me ta, sepse shumica e mangësive në realizimin

e së drejtës së arsimimit, mund të zgjidhen në mikro, apo në nivel lokal, ku nuk janë të nevojshme mekanizma kombëtar apo ndërkombëtar për zgjidhjen e tyre. Trupat që funksionojnë në nivel lokal, gjithashtu mund të jenë më të përgatitur, në krahasim me trupat kombëtar, sepse janë të gatshëm të dëgjojnë ankesa dhe të gjejnë zgjidhje.

2.4. E drejta e arsimimit në përputhje me ligjvënien e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Republika e Maqedonisë së Veriut ka nënshkruar dhe ka ratifikuar disa dokumente ndërkombëtare, me anë të së cilëve është obliguar të sigurojë të drejtën e arsimimit për qytatarët e saj. Por përveç shtetit, të gjithë qytatarët janë të obliguar të ndjekin, respektojnë dhe të mbrojnë këtë të drejtë. Kjo del nga Deklarata e Përgjithshme e së Drejtave të Njeriut në të cilën thuhet se secili individ do të synojë drejt rritjes së të drejtave dhe të lirive të njeriut, si dhe drejt sigurimit tërespektimit dhe pranimi të tyre të përgjithshëm dhe ndërveprues. Duke pasur parasysh faktin se fëmijët nuk kanë të drejtë vote apo të drejtë për ngtijen e zërit politik i cili nevojitet për t'i siguruar të drejtat e tyre, obligim i të rriturve (së pari i prindërve të tyre, kujdestarëve dhe mësuesve) është që të kujdesen për të realizuar interesat e tyre më të ngushtë dhe të mbajnë llogari për të drejtat e tyre, në të cilat përfshihet edhe e drejta e arsimimit dhe këto të drejta të respektohen plotësisht.

E drejta e arsimimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut është e rregulluar nëpërmjet aktit më të lartë të shtetit ,Kushtetutës. Neni 44 i Kushtetutës së RMV-së thotë: „Secili ka të drejtë të arsimohet. Arsimimi është në dispozicion të secilit, me kushte të barabarta. Arsimi fillor është falas dhe obligativ“²⁶.

Me Ligjin për arsimin fillor të RMV-së, e drejta e arsimit fillor është e rregulluar me Nenin 3: „(1) Secili fëmijë ka të drejtë në edukim cilësor dhe falas fillor dhe në arsimim në kuadër të shkollave fillore.(2) Në kuadër të shkollimit fillor mund të përfshihen edhe fëmijë të moshës madhore, në përputhje me Ligjin e Arsimit për të Rritur“²⁷. Me këtë rast me anë të

²⁶Устав на РС Македонија, достапен на

<https://www.sobranie.mk/content/Odluki%20USTAV/UstavSRSM.pdf>, пристапено на 04.05.2020

²⁷Закон за основно образование, достапен на <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-osnovno-obrazovanie-05-08-2019.pdf>, qasur më 04.05.2020

këtij Ligji, Neni 5, ndalon secilin lloj të diskriminimit të drejtpërdrejtë apo indirekt, thirrje apo inicim të diskriminimit, si dhe ndihmë gjatë sjelljes, e cila klasifikohet si diskriminuuese. Diskriminimi përfshinë baza të ndryshme edhe atë: „gjini, racë, ngjyrë të lëkurës, përkatësi kombëtare apo etnike, pengesa, orientim seksual, indentitet gjinor, shtetësi, përkatësi sociale, arsimim, përkatësi apo bindje fetare, bindje të tjera, moshë, gjendje familjare apo martesore, status pronësor, gjendje shëndetsore, si dhe status shoqëror, apo çfardo bazë tjetër e cila është e paraparë me ligj, apo me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut në realizimin e së drejtave nga shkollimi fillor“. Me anë të Ligjit për arsim fillor, Neni 10, rregullohet përdorimi i gjuhëve. Sipas këtij neni, pjesëtarët e bashkësive etnike, kanë të drejtë të ndjekin mësimin i cili mbahet në shkrimin dhe në gjuhën e tyre amtare, ku të mësuat e shkrimit dhe gjuhësh maqedonase janë të obligueshme. Neni 11 ka të bëjë me arsimimin inkluziv. Në fakt, arsimi fillor përkrahë inkluzivitetin e të gjithë fëmijëve me ç'rast „infrastruktura, mbështetja e individualizuar, plani mësimor dhe programi në kuadër të shkollimit fillor, janë të përshatura në mënyrë të arsyeshme, sipas nevojave individuale të nxënësit“. Në përputhje me rregullat ndërkombëtare, në Nenin 13 sqarohet mes tjerash se, të drejtën e shkollimit fillor në kushte të barabarata, si edhe fëmijët të cilët janë shtetas të këtij vendi, kanë edhe „fëmijët me shtetësi tjetër apo fëmijët pa shtetësi, fëmijët refugjatë, azil kërkuesit, fëmijët me status të pranuar të regugjatis, fëmijët me mbrojtje të suspenduar, fëmijët nën mbrojtje të përkohëshme që qëndrojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut“. Me këtë Ligj nuk janë anashkaluar edhe fëmijët që nuk kanë ndjekur mësim. Në fakt, në përputhje me Nenin 14, fëmijëve të këtillë u mundësohet përfshirje në klasa përkatëse të arsimit fillor, nën rregulla të definuara.

E drejta e arsimit të mesëm është e definuar me anë të Nenit 3, të Ligjit për Arsim të Mesëm: „*Arsimi i mesëm është i obliguar për çdo qytetar, me të drejta të barabarta të rregulluara në bazë të këtij Ligji. Arsimi i mesëm në shkollat e mesme publike është falas. Nuk lejohen diskriminime në bazë të gjinisë, racën, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë etnike dhe sociale, bindjeve politike dhe fetare, pozitës pronësore dhe shoqërore*“²⁸. Me këtë ligj, përmes Nenit 4 mundësohet që pjesëtarëve të bashkësive tjera etnike t’ju garantohet mësim në gjuhën e tyre anëtare, ndërsa në përputhje me Nenin, shtetasit e huaj dhe personave pa

²⁸Закон за средно образование, достапен на линкот http://mon.gov.mk/images/Закон_за_средното_образование_пречистен.pdf, qasur më 10.05.2020

nënshtetësi, u garantohet e drejta e arsimit të mesëm. Nent 39 dhe 40 i përfshijnë nxënësit me nevoja të veçanta, të cilët mësojnë sipas programeve përkatëse të përshtatura.

E drejta e arsimimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut përfshihet edhe përmes dy ligjeve. Bëhet fjalë për Ligjin për azil dhe mbrojtjes së përkohëshme dhe Ligjit për shtetasit e huaj. Në përputhje me Ligjin për azil dhe mbrojtjes së përkohëshme, Neni 64 thotë: *“Personat nën mbrojtjen e përkohëshme, kanë të drejtën e arsimit fillor dhe të mesëm, ndërsa sa u përket niveleve më të larta të arsimimit, këto persona kanë trajtim të njëjtë me shtetasit e huaj me qëndrim të lejuar në shtet”*²⁹. Në Ligjin për shtetasit e huaj, Neni 113 përshkruan se shtetasi i huaj që i është miratuar qëndrim i vazhdueshëm në vend, ka të drejtë të arsimit si shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut ³⁰. E drejta e arsimimit dhe mos diskriminimit përfshihen edhe në Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve.

Pabarazite në arsim paraqiten dhe në shoqëri të shtetit ku jetojmë ne. Janë pjesë perberese e statikes shoqërore dhe ato të njëjtat i krijojnë dinamika sociale të kuptuar në stilin kontian,

Pabarazite në arsim në një kohë të gjatë janë trajtuar në kuadër të sociologjisë dhe veçmas në lëmin e stratifikimit shoqëror, problemeve të varfërisë dhe ndarjes së shoqërisë në klasa.

Por me zhvillimin e shoqërisë së arsimit si disiplinë sociologjike rritet dhe interesimi shkencor për këtë dukuri shoqërore. Pluralizmi i demokracisë liberale si çështje vitale e të drejtave të njeriut, paraqesin sigurimin mundësive të njëjta të gjithë njerëzit pa dallim rase, religjioni, etnie, statusi social etj.

Por çdoherë kredibiliteti shoqëror, përparimi në punë ose të një shtrese shoqërore varet nga kualifikimi i duhur, arsimit dhe kredibiliteti profesional i fituar në institucionet që shteti i ka akredituar në ligj për atë qëllim,

Pra, ky promovim është i paravendosur dhe i paralajmëruar dhe të gjithë qytetarët kanë shanse të njëjta të informohen, të konkurojnë në kushte të njëjta, të bëjnë gara me të tjerët (të ndjekin mesimet dhe të fitojnë shkallën e caktuar të kualifikimit gjithnjë në rregulla të njëjta të lojës).³¹

²⁹<http://www.pravo.org.mk/documentDetail.php?id=88>, qasur më 07.05.2020

³⁰<https://mvr.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20stranci%2097-18.pdf>, qasur më 07.05.2020

³¹Hasan. J. „Sociologjia e arsimit”, fq 45, Interlingua, Shkup, 2005.

Kapitulli III

Republika e Maqedonisë së Veriut dhe implementimi i së drejtës së arsimimit dhe mosdiskriminimit

3.1. Raportet e trupave për të drejtat e njeriut pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara

Për Republikën e Maqedonisë së Veriut, sa u përket të drejtave të njeriut, deri më tani janë përgatitur tri shqyrtime periodike edhe atë në vitin 2009, në vitin 2014 dhe në vitin 2019³².

Në shqyrtimin e tretë periodik, raporti i cili përmban kompilacion informatash deri te Organizata e Kombeve të Bashkuara për Republikën e Maqedonisë së Veriut, i përgatitur nga ana e Kabinetit të komisarit të lartë të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, janë informatat vijuese në lidhje me të drejtën e arsimimit dhe mos diskriminimit³³:

- ❖ UNECO-ja e përshëndet implementimin e Strategjisë Kombëtare për uljen e nivelit të varfërisë dhe mos përfshirjes sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2010-2020), Strategjia Kombëtare për zhvillimin e arsimit (2005-2015), si dhe Strategjia Kombëtare për barazi dhe mos diskriminim (2012-2015), të gjitha këto kanë për qëllim që arsimin ta bëjnë më inkluziv, sidomos për nxënësit që i përkasin grupeve të minoriteteve.
- ❖ UNESCO-ja thekson se mundësitë për arsimimin e të gjithë fëmijëve, pa dallim të prapavijës së tyre ekonomike apo sociale, gjithnjë mbetet problem i rëndësishëm. Ekzistojnë dallime të theksuara sa i përket hapave të ndërmara që kanë të bëjnë me ndjekjen e të gjitha niveleve të arsimit, te nxënësit e mjediseve urbane dhe të atyre në mjediset rurale, si dhe ndërmjet nxënësve më të pasur dhe më të varfër.
- ❖ Komiteti për të drejtat e personave me nevoja të veçanta shtetit i rekomandaon që të revidojë Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve dhe Ligjin për arsim fillor, në mënyrë që ata

³²<https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/MKindex.aspx>, qasur më 10.05.2020

³³<https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G18/341/06/PDF/G1834106.pdf?OpenElement>, qasur më 10.05.2020

thelbësisht promovojnë arsimin inkluziv dhe me këtë përfshijnë nevojat e tyre të veçanta, si bazë për diskriminim.

- ❖ UNESCO-ja propozon që shteti t'i intenzifikoje përpjekjet e tij të mëtejme për promovimin e arsimit inkluziv dhe procesin e avancimit të regjistrimit dhe ruajtjes së vazhdimësisë së nxënësve të grupeve minoritare, sidomos të nxënësve romë dhe të sigurohet qasje deri në arsimim për të gjithë fëmijët, konkretisht për fëmijët pa dokumenta personale.
- ❖ Komisioni për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore, propozon që shteti t'i ndërrmer të gjitha masat e nevojshme për zgjidhjen e pranisë së numrit të madh të nxënësve romë, në kuadër të shkollave speciale dhe paraleleve speciale në kuadër të shkollave të rregullta, duke përfshirë këtu edhe shqyrtimin e kriterëve për klasifikim dhe miratim të programeve inkluzive dhe të integruara të arsimit.
- ❖ Komiteti për të drejtat e personave me nevoja të veçanta, propozon që shteti në mënyrë të menjëhershme të miratojë ligj për të siguruar arsimim inkluziv për personat me nevoja të veçanta, në të gjitha nivelet, duke përfshirë këtu edhe institucionet e arsimit të lartë.
- ❖ Komisioni për eliminimin e diskriminimit racor propozon që shteti të marrë pjesë në ngritjen e vetëdijes në mesin e popullatës, sidomos të bashkësitë më të prekura, ndaj ndikimit negativ të diskriminimit ndaj arsimit, shëndetësisë dhe mundësive për punësimin e femrave.

Raporti kombëtar, i publikuar në kuadër të ciklit të tretë, në lidhje me të drejtën e arsimit dhe mosdiskriminimit, i përmban miratimet vijuese³⁴:

- Është miratuar Strategjia për Romët 2014-2020 e cila përfshinë disa fusha prioritare, për të cilat janë paramenduar edhe plane aksionale: punësim, arsimim, strehim adekuat, mbrojtje shëndetsore dhe avancim të statusit të grave romë në shoqëri.
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS), në bashkëpunim me Fondin për Arsimimin e Romëve, zbaton projektin „Përfshirja e fëmijëve romë në kuadër

³⁴<https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G18/343/58/PDF/G1834358.pdf?OpenElement>, qasur më 10.05.2020

të institucioneve publike komunale – çerdhet e fëmijëve“ në kohëzgjatje prej njëmbëdhjetë viteve.

- Numri i përgjithshëm i fëmijëve të regjistruar në çerdhe në vitin shkollor 2017-2018 është 34.521, 718 ose 2,07% prej tyre janë romë. Numri i përgjithshëm i fëmijëve të regjistruar jashtë projektit (prindër të cilët personalisht e mbulojnë qëndrimin e fëmijëve në çerdhe) është 204.
- Sipas projektit, 19 romë–kujdestarë për fëmijë, janë të punësuar në bazë të vazhdueshme dhe të nejtët tashmë janë pjesë e personelit në kuadër të institucioneve parashkollore.
- Sa i përket aksionit për evidentimin e personave të cilët nuk figurojnë në regjistrin e të posalindurve, Regjistri Qytetar, në koordinim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, në fund të muajit mars të vitit 2018, publikoi shpallje publike për regjistrimin dhe për grumbullimin e të dhënave për personat lindja e të cilëve nuk është e evidentuar në librin amë, apo të cilët nuk kanë marrë certifikatën e parë të lindjes.
- Sipas ligjeve për arsim fillor dhe për arsim të mesëm, arsimi fillor për nxënës me nevoja të veçanta në arsim, organizohet dhe realizohet në shkolla të rregullta dhe speciale fillore, apo në paralele të veçanta, në kuadër të shkollave të rregullta, ndërsa arsimi i mesëm është organizuar dhe siguar në kuadër të shkollave të rregullta dhe speciale të mesme, në përputhje me programet mësimore të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit.
- Me ndryshimin e Ligjit për Arsim Fillor nga viti 2017 parashihet që shkollat të formojnë ekipe inkluzive për nxënës me nevoja të veçanta në arsim.
- Mësimdhënësit dhe asistentët personal i mbështesin fëmijët me pengesa gjatë procesit të të mësuarit. Gjatë vitit shkollor 2017/2018 ka pasur gjithsej 140 asistentë të punësuar në 18 komuna nga 1 tetor i vitit 2017, deri në 1 qershor të vitit 2018. Përveç kësaj, ka 74 mësimdhënës special në kuadër të shkollave të mesme.
- Nga vitit 2012, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka ndarë 50 bursa për nxënësit me nevoja të veçanta në arsim për çdo vit.

- Në kuadër të shkollave fillore është miratuar Rregullore për numrin e nxënësve me nevoja të veçanta në arsim në kuadër të klasës, që pasqyron mënyrat dhe kushtet për regjistrimin e nxënësve me nevoja të veçanta në arsim.
- Janë siguruar mjete për komunat si bllok shtesa për fëmijët me nevoja të veçanta.
- Strategjia e re gjithpërfshirëse e arsimit 2018-2025 përfshinë masa për avancimin e arsimimit inkluziv.
- Si pjesë e programit katërvjeçar (2017-2020) për punën e Qeverisë dhe i planeve vjetore dhe programeve të punës së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, janë programuar aktivitete për zbatimin apo realizimin e dokumenteve vijuese strategjike: Strategjia e Arsimit të Integruar; Strategjia Kombëtare për Romët 2014-2020 dhe Strategjia e Arsimit për vitet 2018-2025.
- Në kontekstin e qëllimeve të përmendura në këto programe, në nivel vjetor ndërmerren aktivitete për zgjerimin e rrjetit të objekteve për fëmijë, si që janë çerdhet/qendra për zhvillimin e fëmijëve, me qëllim të sigurimit të qasjes së barabartë deri te institucionet për të gjithë fëmijët.
- Investim në përmirsimin e cilësisë së arsimimit është proces i vazhdueshëm që përfshin jo vetëm intervenimet infrasktruturore, por edhe intervencat në kuadër të programeve mësimore dhe matarealeve programore mësimore, si dhe investimeve në kapitalin njerëzor të a.q. sigurim të vazhdueshë të trajnimeve dhe zhvillimit profesional të personelit mësimor dhe profesional.
- Ndermerren aktivitete që kanë të bëjnë me renovimin dhe rikonstruimin e godinave shkollore në kuadër të arsimit fillor dhe të mesëm në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vijuar edhe investimet në kuadër të ndërtimit të institucioneve të reja arsimore dhe sallave sportive.
- Në përputhje me konceptin për klasën e nëntë për arsimin fillor, mësimi vijon në katër gjuhë mësimore (në gjuhën maqedonase, shqipe, turke dhe serbe), ku bashkësitë etnike të cilave nuk u ofrohet mësim në gjuhën e tyre amtare, të njëjtën mund ta mësojnë si lëndë zgjedhore, si që është gjuha dhe kultura: e boshnjakëve, vllehëve, romëve. Lëndët zgjedhore vijnë nga klasa e tretë deri në klasën e nëntë, me nga një apo me

nga dy orë në javë. Byroja për Zhvillimin e Arsimit e përgatit programin mësimor për këto lëndë zgjedhore

- Pas ligjërimit eksperimental dymbëdhjetë vjeçar në gjuhën boshnjake nga viti shkollor 2018/19, gjuha boshnjake bëhet gjuhë formale në mësimin e rregullt nga klasa e parë, në tri shkolla fillore dhe nga viti shkollor 2019/20 do të ketë mësim të këtillë edhe nëpër shkollat tjera ,atje ku ekziston interesim dhe atje ku janë plotësuar kushtet e vërtetuara me Ligjin për Arsim Fillor.
- Me qëllim të sigurimit të qasjes më të mirë dhe zbatimit të arsimit, angazhohen mediatorë mësimorë romë nëpër komuna të caktuara; ndahen bursa për nxënësit romë; angazhohen edukatore dhe mentor për nxënësit romë; ndahen bursa për studentët romë dhe për universitetet në të cilat ata ndjekin studimet.
- Prioritete vijuese që duhet të realizohen nga viti shkollor 2019/20, përfshijnë përmirsimin e standardeve për arsimin fillor dhe atë të mesëm, përmes sigurimit të masave përkatëse për qasje deri në arsimim për fëmijët të cilët nuk kanë ndjekur mësim
- Sipas të dhënave, numri i fëmijëve romë të cilët janë pjesë e arsimit fillor ka rritje positive progresive, jo vetëm sa i përket regjistrimit në shkolla fillore, por edhe sa i përket numrit të fëmijëve romë të cilët me sukses e kanë përfunduar këtë nivel të arsimit. Në vitin shkollor 2016/17, kanë qenë pjesë gjithsej 9.362 nxënës të cilët kanë ndjekur shkollimin fillor nga klasa e parë deri në klasën e nëntë (4.559 prej të cilëve kanë qenë nxënës rome). Gjatë vitit shkollor 2017/18, ky numër është rritur në 9.679 nxënës (4.668 kanë qenë nxënës rome).
- Gjatë vitit shkollor 2016/17, 2,041 nxënës, të cilët janë deklaruar se i përkasin etnitetit romë, kanë vijuar ndjekjen e arsimit të mesëm, nga viti i parë, deri në vitin e katërt (706 prej të cilave kanë qenë nxënës rome).
- Në mënyrë që të reduktohet numri i vajzave rome të cilat i braktisin shkollat, ka filluar një nismë e përbashkët e cila i përfshinë Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim që të rritet niveli i vetëdijes te popullata rome që i përket gjinisë femërore rome, në lidhje me martesat e hershme, si dhe vendosjes së trajnimeve për kuadrot mësimore dhe

profesionale në kuadër të shkollave, për zbulimin e hershëm të braktisjes potenciale të shkollës. Një sërë masash mbrojtëse juridike për vendosjen e protokolleve, planifikohet si një kundër përgjigje ndaj këtij fenomeni.

- Me qëllim të mbështetjes dhe fuqizimit të aktiviteteve që kontribuojnë në zhvillimin dhe promovimin e multikulturalizmit, integritit dhe tolerancës ndër etnike në kuadër të arsimit, janë miratuar ndryshime në ligjet për arsimin fillor dhe atë të mesëm; me anë të programeve kreative në këtë segment, të gjitha shkollat mund të aplikojnë Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në mënyrë që të fitojnë mjete për realizimin e aktiviteteve të këtilla, në një shumë që nuk tejkalon shifrën më të madhe se 30,000 denarëve.
- Në kuptimin e cilësisë, pritet që programet dhe aktivitetet e planifikuara të rezultojnë me nivel të lartë të ndërveprimit të grupeve etnike/gjuhësore të përziara dhe të pjëmarrësve dhe në këtë mënyrë të formohen grupe të balancuara të pjesëmarrësve, sipas përkatësisë së tyre etnike, sipas gjinisë dhe moshës. Në këtë kuptim, nga vitit 2017, Ministria e Arsimit dhe Shkencës siguroi mbështetje për shkollat për realizimin e aktiviteteve të këtilla që promovojnë integrimin ndëretnik, tolerancë, etj. 115 shkolla fillore dhe 28 shkolla të mesme, e kanë shfrytëzuar këtë mundësi gjatë dy viteve të fundit (v. 2017 dhe 2018).

Në kuadër të dokumenteve të ciklit të tretë gjendet edhe letra me Aneks nga Komesari i Lartë për të Drejtat e Njeriut i cili nën fusnotën e së drejtës së arsimit thuhet: *marrja e të gjitha masave përkatëse për promovimin e arsimit inkluziv, siguri që grupet e minoriteteve mos anashkalohen dhe personat nga grupet më të prekuara të jenë tërësisht të integruar në sistemin e arsimit*³⁵.

Republika e Maqedonisë së Veriut në kuadër të ciklit të tretë, pranoi 169 rekomandime, ndërsa mbështeti 167 prej tyre. Në ciklin paraprak, këto numra kishin të bëjnë me 136 rekomandime të pranuar, kundrejtë 124 të mbështetura. 13% e rekomandimeve kanë të bëjnë me cilësinë në kuadër të arsimit³⁶.

³⁵https://lib.ohchr.org/HRBodies/UPR/Documents/Session32/MK/HC_letter_North_Macedonia_ENG.pdf, qasur më 12.05.2020

³⁶file:///C:/Users/Lenovo%20V130/Downloads/Infographic_NorthMacedonia.pdf, qasur më 14.05.2020

3.2. Këshilli i Evropës: Raporti i Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jotolerancës

Komisioni Evropian kundër racizmit dhe jotolerancës (European Commission against Racism and Intolerance) është trupi i vetëm monitorues për të drejtat e njeriut, i specializuar për çështjet që kanë të bëjnë me luftën kundër racizmit, diskriminimit (në bazë „racës“, përkatësisë etnike / kombëtare, ngjyrës, shtetësisë, religjionit, gjuhës, orientimit seksual dhe identitetit gjinor), ksenofobisë, antisemitizmit dhe jotolerancës në Evropë.

I themeluar në Samitin e Shefave të Shteteve dhe Qeverive të vendeve antëree të Këshillit të Evropës në vitin 1993, hyn në funksion në vitin 1994, ky trup numëron gjithsej 47 anëtarë, të emëruar në bazë të pavarësisë, pa anshmërisë, autoritetit moral të tyre, si dhe ekspertizën për ballafaqim me çështjet e racizmit, diskriminimit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe jotolerancës (secili vend anëtar i Komisionit të Europës emëron një person të shërbejë si anëtarë)³⁷.

Në punën e tij hulumtuese Komisioni Evropian, kundër racizmit dhe jotolerancës e analizon ngushtë siguataën në secilin nga vendet anëtare dhe jep rekomandime për ballafaqim me çfardo problemesh që do të identifikohen, e që lidhen me racizmin dhe jotolerancën. Para përgatitjes së secilit raport të ri, organizohet vizitë në shtetin përkatës, ku delegacioni i këtij trupi konsultohet me lojtarët kyç në luftën kundër racizmit dhe jotolerancës në vendin përkatës. E gjitha kjo bëhet me qëllim që të kemi një fotografi sa më të qartë ndaj situatës në vend. Puna është e organizuar në pesë cikle vjetore, duke mbuluar apo përfshirë 9 nga 10 vende për një vit. Me këtë rast, të gjitha vendet anëtare kanë trajtim të barabratë dhe janë në nivel të njëjtë.

Raportet e këtij trupi paraqesin sublimat të materialeve të fituara nga shumica e burimeve të ndryshme. Në rast se aurotoretet kombëtare dëshirojnë, ka mundësi që së bashku me raportin të jenë të publikuara edhe qëndrimet e tyre.

Sa i përket Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni Evropian kundër racizmit dhe jotolerancës ka publikuar disa raporte në periudhat gjegjëse³⁸:

³⁷<https://rm.coe.int/leaflet-ecri-2019/168094b101>, qasur më 20.05.2020

³⁸<https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia->, qasur më 21.05.2020

- Raporti i parë, i miratuar më 16 tetor 1998, i publikuar më 24 maj 1999,
- Raporti i dytë, i miratuar më 16 qershor 2000, i publikuar më 3 prill 2001,
- Raporti i tretë, i miratuar më 25 qershor 2004, i publikuar më 15 shkurt 2005,
- Raporti i katërt, i miratuar më 28 prill 2010, i publikuar më 15 qershor 2010,
- Konkluzë, të miratuara më 20 mars 2013, të publikuara më 9 qershor 2014,
- Raporti i pestë, i miratuar më 18 mars 2016, i publikuar më 7 qershor 2016,
- Konkluzë, të miratuara më 3 prill 2019, të publikuara më 6 qershor 2019

Raporti i pestë dhe i fundit për Republikën e Maqedonisë së Veriut ka të bëjë me katër tema të cilat janë të përbashkëta me vendet tjera:

- a) ligjdhënia
- b) gjuha e urretjes
- c) dhuna dhe
- d) politikat e integritetit,

ndërsa janë të përfshira edhe temat të cilat janë specifike për vendin. Me këtë rast, është përfshirë edhe situata e vendit, nga data 9 dhjetor 2015.

Në raportin e pestë, krahasuar me raportin paraprak, është konstatuar përparim në shumë fusha. Sa i përket ligjdhënies është konstatuar se:

- Në vitin 2010 është miratuar Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, „ku në mesin e bazave të diskriminimit i parasheh racën, ngjyrën e lëkurës, përkatësinë etnike, gjuhën, shtetësinë dhe religjionin“³⁹.
- Në vitin 2014, Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me misionin e OSBE-së në Shkup, formoi grup të punës për krim nga urrejtja.
- Në vitin 2015, Ministria e Punëve të Brendshme hapi linjën e kuqe në të cilën qytetarët do të kenë mundësi që përmes internetit të paraqesin gjuhë të urretjes ose të dorëzojnë ankesë.
- Në vitin 2014, miratohet korniza e re ligjore e cila duhet të zbatohet nga fundi i vitit 2015 dhe e cila ka të bëjë me punësimin në shërbimin shtetëror dhe sektorin publik. Në përputhje me këtë, procesi i punësimit do të orientohet drejt pjesëtarëve të të gjitha

³⁹<https://rm.coe.int/fifth-report-on-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-macedonian-t/16808b590d>, qasur më 21.05.2020

bashkësive etnike dhe do të vendoset sistem grumbullimin e të dhënave të segreguara etnike për punësim në sektorin publik.

- Është miratuar Strategjia për Romët për periudhën e viteve 2014-2020,
- Deri në fund të vitit 2015, duhet të miratohen planet kombëtare aksionale për katër fushat e para për përkrahjen ndaj grave romë.

Ajo që e brengosë Komisionin Evropian kundër racizmit dhe jotolerancës sa i përket Republikës së Maqedonisë së Veriut është:

- Mospërputhshmëria e Ligjit Penal me rekomandimin e përgjithshëm numër 7 të dhënë nga ana e Komisionit.
- Boshllëqet në pjesët e fushave të së drejtës qytatare dhe administrative. Në fakt, Komisioni është i mendimit se për shkak të pezullimit të punësimeve në sektorin publik, në zyrën e obdusmanit kemi mungesë të kuadrit që ndikon ndaj kryerjes profesionale të punës së këtij trupi.
- Tensionet e shumta për shkak të bashkësive më të mëdha etnike.
- Gjuha raciste e urretjes e cila krijon atmosferë të dhunës racore.
- Jotoleranca brengosëse e bashkësisë LGBT
- Nxitja e urretjes homofobike/transfobike
- Parandalimi dhe dënimi joefikas ndaj dhunës dhe urretjes së orientuar drejt bashkësisë LGBT
- Forma të ndryshme të diskriminimit dhe jotolerancës në jetën e përditshme të anëtarëve të bashkësisë LGBT.
- Margjinalizimi shoëqror dhe ekonomik i romëve, në arsim, punësim, vendit të jetesës dhe sigurimit shëndetsor
- Profilim racor i romëve në vendkalimet kufitare (nga ana maqedonase)
- Pa mundësia për t'u regjistruar në disa bashkësi fetare.

Në raportin e pestë, rekomandimet nga Komisioni Evropian kundër racizmit dhe jotolerancës për Republikën e Maqedonisë së Veriut janë:

- 1) Përputhshmëria apo pajtueshmëria e Ligit Penal dhe dispozitat relevante juridiko-qytetare dhe juridiko-administrative me rekomendimin e përgjithshëm nr. 7 të KE-së.
- 2) Pajtueshmëria e së drejtës qytetare dhe administrative me rekomandimin e përgjithshëm nr. 7 të KE –së.
- 3) Plotësimi i vendeve të zbazëta të punës tek Obdusmani dhe sigurim i shërbimit profesional i cili do të sigurojë mbështetje për Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi.
- 4) Nxitja e akuzës së gjuhës së urretjes nga ana e politikanëve dhe nga ana e partive politike
- 5) Rihapja e Strategjisë për Arsimim të Integruar me përgatitjen e planit përkatës aksional dhe sigurimin e mjeteve financiare për zbatimin e saj.
- 6) Vendosja e kuotave për pjesëtarët e bashkësive historikisht më të vogla etnike, gjatë punësimeve në sektorin publik dhe ndjekje e ndikimit të tyre.
- 7) Promovim dhe fuqizim të punës së komisioneve lokale për marrëdhëniet ndërmjet bashkësive etnike.
- 8) Sigurimin e numrit të mjaftueshëm dhe hapësirave të përshtatshme sociale për pjesëtarët e grupeve të prekura të bashkësisë rome
- 9) Qasje e barabartë deri te sigurimi shëndetsor për pjesëtarët e bashkësisë etnike rome, sidomos trajtim të barabartë gjinekologjik dhe shërbime permanente
- 10) Të mos ndalohet së anuluari praktika e orientimit të fëmijëve romë në institucionet arsimore, të cilat janë të dedikuara për fëmijët me pengesa në zhvillimin psikik Sigurimin e mjeteve, mbështetje për personat e papunë, pjesëtarë të bashkësisë etnike rome, në formë të vlerësimit të shkathtësive të tyre dhe sigurimit të mundësive përkatëse të tranjimit.
- 11) Zgjidhja e problemit përmes qasjes deri te dokumentet personale, problem me të cilin romoët ballafaqohen vazhdimisht.
- 12) Trajnimi i policisë, prokurorisë publike dhe gjyqësisë, në raport me dhunën homofobike dhe transfobike.

- 13) Ndërrmarja e masave në mënyrë që të përmirsohet marrëdhënia ndërmjet policisë dhe grupet e prekura të shoqërisë.
- 14) Ndërtimi i mirëbesimit ndërmjet policisë dhe bashkësisë LGBT-së.
- 15) Zgjidhja e çështjes për regjistrimin e grupeve fetare minoritare pa pasur ngarkesë ndaj formaliteteve më të mëdha.
- 16) Trajnim përkatës për policinë kufitare me qëllim të realizimit të detyrave të saj pa profilim racor.
- 17) Realizim të hulumtimeve të pavarura së bashku me bashkësinë LGBT për format e diskriminimit, bashkësia përkatëse e cila do të mundësojë përgatitjen dhe miratimin e planit aksional për eliminimin e formave të diskriminimit.
- 18) Rregullimin e procedurës dhe kushteve për ndryshim të gjinisë dhe dhënien e dokumenteve të reja personale, për personat të cilat kanë kaluar fazën e operacionit për të ndryshuar gjininë e tyre.
- 19) Refugjatëve dhe tëhuajve për periudhën e viteve 2008-2015.

Për rekomandime prioritare, Komisioni Evropian kundër racizmit dhe jotolerancës, i merr parasysh rekomandimet e publikuara nën numrin rendor tre dhe tetëmbëdhjetë.

Konkluzat e fundit nga ana e Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jotolerancës në lidhje me rekomandimet e dhëna, janë publikuar më 6 qershor 2019. Në to, thuhet se sa i përket të drejtave, rekomandimit prioritar, punët zhillohen në drejtimin e duhur. Në fakt, në vitin 2017, zyra e Obdusmanit nga Ministria e Financave, ka marrë pëlqim të plotësoi 10 vende të zbarzëta. Në gusht të vitit 2018, nga gjithsej 142 pozicione që ekzistojnë në kuadër të zyrës së Obdusmanit, në përputhje me „Rregulloren për sistematizim në vende tëpunës“, janë plotësuar gjithsej 79 vende.

Sa i përket pjesës së dytë të këtij rekomandimi, Komisioni ka qenë i informuar nga ana e autoriteteve se draft Ligji i reviduar për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi përmban dispozitë për vendosjen e mbështetjes për shërbime profesionale, administrative dhe teknike të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Komisioni Evropian kundër racizmit dhe jotolerancës e përshëndet një hap të këtillë, por gjithashtu thekson se gjithnjë ligji në fjalë nuk është mirataur dhe zbatuar në tërësi. Edhe pse KE potencon se masat e lartëcekura janë gjithnjë të pamjaftueshme, ai është i mendimit se rekoamndimi është pjesërisht zbatuar.

Sa i përket rekoamdnimit të dytë, i cili ka të bëjë me zbatimin e hulumtimeve me bashkësinë LBGT-së dhe hapjen e rrugës në drejtim të përgatitjes dhe miratimit të planit aksional për vënien fund të formave të ndryshme të diskriminimit, autoritetet e kanë njoftuar Komisionin Evropian, se Ministria e Punës dhe Politikës Sociale është trup përkatës qeveritar për mundësi të barabarta dhe punë dhe politikë jodiskriminuese, së bashku me bashkësinë LBGT-në. Megjithatë, Komisioni gjithashtu është e informuar, se aurotoretet nuk kanë zbatuar asnjë studim gjithpërfshirës dhe të pavarur, për të gjitha format e diskriminimit kundër personave LBGT, ashtu siç është rekomanduar nga KE-ja. Për këtë, Komisioni Evropian kundër racizmit dhe jotolerancës, është i mendimit se ky rekomandim nuk është i implementuar.

3.3. Komisioni Evropian: Raporti për përparimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Raportet që kanë të bëjnë me përparimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga ana e Komisionit Evropian, përfshijnë disa fusha vijuese: gjendja politike, puna e administratës publike, sistemi juridik, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtat themelore të njeriut, bashkëpunimi rajonal, gjendja ekonomike..

Sipas raportit të vitit 2019, korniza ligjore për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, në masë të madhe është në përputhje me standardet evropiane dhe vendi ka arritur përparim të mjaftueshëm. Është mundur nivel më i lartë i mbrojtjes nga krimi, nga urrejtja dhe diskriminimi, me anë të ndryshimeve në kuadër të ligjit penal dhe me anë të miratimit të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi.

Në fushën e arsimit, sipas raportit, vendi ka arritur nivelin e mjaftueshëm të gatishmërisë. Është arritur përparim i kufizuar, me anë të miratimit të Ligjit të ri për arsim të lartë. Kemi vendosjen e kufizuar të masave nga strategjia gjithpërfshirëse e arsimit për vitet 2018-2025. Duke pasur parasysh që rekomandimet e viteve të kaluara nuk janë zbatuar, ato ngelin valide. Gjatë vitit të ardhshëm, vendi duhet veçanërisht të⁴⁰:

⁴⁰<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-north-macedonia-report.pdf>, qasur më 23.05.2020

- ❖ mplementojë kornizën e re strategjike për arsimin, sidomos për qëllimet në kuadër të arsimit parashkollor;
- ❖ të rritë nivelin e përkrahjes sa i përket trajnimeve të mësimdhënësve dhe zhvillimit profesional, si dhe të sigurojë proces efikas të vlerësimit;
- ❖ të përmirsojë qasjen deri tek arsimimi cilësor për të gjithë, veçanërisht gjatë regjistrimit të fëmijëve nga mosha parashkollore, të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe të fëmijëve të përkatësisë etnike rome.

Sipas raportit të vitit 2019, brengosës është edhe niveli i regjistrimit në arsimimin e hershëm. Megjithatë, edhe pse vendi shënon përparim në regjistrimin nëpër çerdhe, nga 22% në vitin 2012, në 30% në vitin shkollor 2018/2019, kjo është larg nga përqindja e dhënë nga ana e BE-së që duhet të arrijë 95%. Kjo do të thotë, që dy e treta e fëmijëve në vendin tonë, e humbin këtë mundësi për përmbushjen e potencialit të tyre. Megjithatë, Qeveria, ndërmerr masa për rritjen e resurseve dhe për përmirsimin e kushteve në kuadër të institucioneve parashkollore, me anë të investimit në infrastrukturën parashkollore dhe me anë të trajnimeve të cilësisë së lartë për mësimdhënësit në kuadër të arsimit parashkollor. Në përputhje me raportin, gjithnjë është i nevojshëm përmirsim i theksuar në kuadër të cilësisë së arsimit fillor dhe atij të mesëm. Është vërtetuar përqindje e lartë e përfundimit të shkollimit fillor dhe të mesëm, por mangësi hasim në lidhje me rregullshmërinë e fëmijëve romë. Në fakt, rreth 10% e fëmijëve të përkatësisë etnike rome, në mënyrë të ç'rregullt vijnë në arsimin fillor, ndërsa përqindja e braktisjes së shkollës mbetet mjaft e lartë. Cilësia e arsimit është brengosëse në të gjitha nivelet dhe sistemi mbetet i cunguar ndaj ndikimeve politike dhe korrupsionit. Fëmijët dhe nxënësit me nevoja të veçanta, si dhe fëmijët e përkatësisë etnike rome, vazhdojnë të ballafaqohen me barriera të arsimit dhe trajnimit të rregullt dhe cilësor. Në dhjetor të vitit 2018, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, mori vendim me të cilin kërkohet që komunat t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet parashkollore për fëmijët e regjistruar romë, nga janari i vitit 2019.

Në raportin gjegjës thuhet se ndasitë e fëmijëve në vija etnike në kuadër të procesit arsimor, vazhdon. Nuk vërehet ulje e butë e numrit të shkollave në të cilat nxënësit mësojnë ndaras. Barriera të theksuara mbeten edhe raportet që kanë të bëjnë me integrimin.

Në kuadër të shkollimit të lartë, përqindja e përgjithshme për regjistrimin e studentëve, pëson rritje për më shumë se 40%, gjatë vitit akademik 2018/2019. Megjithatë,

përqindja e diplomimit, mbetet mjaft e ulët. Qeveria e miratoi Ligjin e ri për arsim të lartë në maj të vitit 2018, pas miratimit të Strategjisë për Arsim 2018/2025 dhe planin e lidhur aksional në janar të po atij viti. Ky ligj, e fuqizon parimin dhe praktikën e autonomisë universitare dhe i ndan strukturat për vlerësim dhe zhvillim, akreditim dhe testim ekstern në kuadër të programeve studimore dhe institucioneve të arsimit të lartë. Gjithashtu, Ligji i parasheh: Këshillin Kombëtar për Arsimin e Lartë, Këshill për Akreditimin e Arsimit të Lartë dhe Këshillin e Veçantë për Vlerësimin e Arsimit të Lartë, trupa këto që duhet të formohen gjatë vitit 2019.

Sipas sistemit kombëtar kornizë për kualifikim, janë krijuar tri standarde të reja për kualifikim për postarsim të mesëm. Sa i përket bashkëpunimit me punëdhënësit, në shkurt të vitit 2018, janë formuar pesë komitete sektorësh për kualifikim. Këto komitete janë përgjegjëse për analizën e kualifikimeve aktuale, për propozime për vendosjen e kualifikimeve të reja dhe për dhënien e mendimit rreth përputhshmërisë së standardeve profesionale dhe të kualifikuara, me programet paraprahe.

Sa i përket arsimit të mesëm profesional dhe arsimit për të rritur, vijojnë përmirsimet e cilësisë në anën e mësimi praktik dhe në anën e të mësuarit që bazohet në punë. Investimet e mëtejme në kuadër të arsimit të mesëm profesional kanë të bëjnë në zhvillimin profesional të mësimeve dhe në vendosjen e programeve mësimore më fleksibile dhe modulare, me përfshirjen e domosdoshme të punëdhënësve në kuadër të arsimit dhe trajnimit. Rekomandohet apo propozohet mbikqyrje më e afërt e rezultateve nga arsimi dhe trajnimi profesional, si për shembull ndjekja e statusit të nxënësve në tregun e punës.

Në raport thuhet se vendi, gjithashtu ka për qëllim të rritë nivelin e përqindjes së atyre që e njohin shkrim leximin, sidomos te pjesa e të rriturve, me anë të fillimit të programeve për trajnim për përfundimin e shkollimit fillor dhe të mesëm për të rritur. Bëhet fjalë për hap në drejtimin e duhur, por problemi qëndron në atë se nuk janë ndarë një numër i caktuar apo i mjaftueshëm i resurseve. Miratimi i sistemeve për validimin e të mësuarit joformal dhe informal, është edhe një hap pozitiv.

Vendi vazhdon me pjesëmarrje aktive në kuadër të programit Erasmus + dhe është në nivel të barabartë me vendet anëtare të BE-së sa i përket kësaj pikpamjeje. Gjithashtu, vendi është i përfshirë në mënyrë aktive në grupin e hulumtimit e proceseve të Bolonjës. Në vitin 2018, Maqedonia e Veriut është pjesë e programit ndërkombëtar të OECD-së për vitin 2018.

Është bërë vlerësim (PISA) i studentëve për herë të dytë, ndërsa rezultateet e këtij vlerësimi, duhet të publikohen në dhjetor të vitit 2019. Në raport është theksuar se, vendi do të jetë pjesë i studimit ndërkombëtar për matematikë dhe shkencë në vitin 2019, si dhe i studimit ndërkombëtar për shkrim dhe lexim në vitin 2021.

3.4. Analizë e të dhënave statistikore për realizimin e së drejtës së arsimimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në përputhje me të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikave, në vitin shkollor 2018-2019, numri i nxënësve në shkollat fillore të rregullta është 187 240, numër ky që paraqet ulje për 0,5% krahasuar me vitin e kaluar shkollor, përderisa numri i nxënësve në shkollat e mesme të rregullta, në fillim të vitit shkollor 2019/2020 është 69 980, që paraqet ulje për 2,3% krahasuar me vitin shkollor paraprak.

Tabela 1:

Numri i nxënësve në shkollat fillore në R. e Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës nga vitet 2007-08 deri në 2017-18

Viti	Shkolla	Paralele	Nxënës	
			Gjithsej	Nxënëse femra
2007/2008	996	10 647	222 359	107 755
2008/2009	993	10 692	216 180	104 445
2009/2010	989	10 716	210 381	101 765
2010/2011	990	10 720	204 439	98 951
2011/2012	986	10 713	198 856	96 433
2012/2013	991	10 684	195 311	94 695
2013/2014	988	10 877	191 051	92 461
2014/2015	986	10 887	192 165	93 106
2015/2016	988	10 709	185 992	89 949

2016/2017	993	11 427	192 715	93 334
2017/2018	989	11 075	192 448	93 118

Tabela 2:

Numri i nxënësve në shkollat e mesme të R. së Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës nga 2007-08 deri në vitin 2017-18

	Shkolla	Paralele	Nxënës	
			Gjithsej	Nxënëse femra
2007/2008	105	3 228	94 545	44 352
2008/2009	108	3 267	93 843	44 595
2009/2010	111	3 372	95 343	45 820
2010/2011	111	3 433	94 155	45 292
2011/2012	114	3 477	93 064	44 884
2012/2013	113	3 459	89 884	42 975
2013/2014	113	3 455	86 418	41 186
2014/2015	116	3 474	83 522	40 376
2015/2016	117	3 497	80 295	38 330
2016/2017	132	3 533	76 394	36 038
2017/2018	131	3 482	71 458	34 059

Sipas Programit Nacional për Zhvillimin e Arsimit gjatë periudhës së viteve 2005-2015, vetëm 88,47% nga gjenerata e viteve 1997/98 e kanë përfunduar shkollën fillore me kohë, ndërsa vetëm 69,03% nga gjenerata 1997/98 që e ka filluar arsimimin e saj para 12


viteve, ka përfunduar shkollimin e mesëm. Abstenim më të madh të nxënësve prej 16,65%, hasim gjatë kalimit nga shkollimi fillor, në atë të mesëm. Përqindja vjetore e abstenimit në kuadër të shkollimit fillor është 1.71%, ndërsa ky numër pothuajse dyfishohet në kuadër të shkollimit të mesëm, me 2.84%.

Pabarazite ne raport meshkuj femra janë present edhe sot e kësaj dite edhe perkunder shume debateve qe behen ne mes sociologeve, politikanve, gazetarve, shoqatave feministe.

Keto dallimi gjallojne edhe perkunder shume konventave ndërkombetre që ndalojne diskriminimin edhe pse qeverite me anë të akteve legjislative bëjnë politike mosdiskriminimi në baza gjinore.⁴¹

Numri më i madh i abstenimit të nxënësve vërehet te popullata rome. Si arsye merren prejardhja socio-ekonomike e nxënësve, niveli i ulët i arsimimit të prindërve, mosinformimi i prindërve, mospasja e motivit nga ana e tyre, por edhe qëndrimi negative ndaj të mësuarit dhe shkollës, etj. Në këtë mënyrë, gjatë vitit shkollor 2008/2009 kur edhe fillon arsimi i mesëm i obliguar, vetëm 5% e nxënësve të përkatësisë etniker rome, të cilët e kanë përfunduar shkollimin e tyre fillor, nuk janë regjistruar në shkollë të mesme, por gjatë vitit shkollor 2013/2014 vërehet se 65% e nxënësve romë të cilët kanë ndjekur klasën e fundit, nuk janë regjistruar në shkollë të mesme.

⁴¹Hasan. J. „Sociologjia e arsimit”, fq 45. Interlingua, Shkup, 2005



Fotografia nr. 1: Abstenenca e nxënësve romë gjatë kalimit nga shkolla fillore në atë të mesme.

Kur kemi të bëjmë me abstinencën e tyre në kuadër të shkollës fillore, abstenimi më i madh i fëmijëve nga njëri, në vitin tjetër akademik, vërehet gjatë viteve 2014/2015. Në fakt, gjatë vitit shkollor 2013/2014 në klasën e tetë janë regjistruar 1445 nxënës romë, që gjatë vitit vijues shkollor, në klasën e nëntë ky numër të ulet në 685 nxënës, gjegjësisht të kalojë në një abstinencë prej 53%. Në përgjithësi, abstinence mesatare nga një vit, në vitin tjetër shkollor gjatë njëzet viteve të fundit, në kuadër të shkollimit fillor, sillet në kuadër nga 6-8%

Viti shkollor 2005/06	NULTA	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	Gjithsej/Mesatarja
	726	1372	1372	1136	1092	1141	911	792	720	9262
Viti shkollor 2006/07	998	1313	1247	1308	1111	1161	937	796	732	9603
Abstenim nga viti paraprak			9%	5%	2%	-6%	18%	13%		7%
Viti shkollor 2007/08	2443	1198	1221	1281	1134	961	850	697	/	9785
Abstenim nga viti paraprak		9%	2%	2%	-2%	17%	9%	12%		7%
Viti shkollor 2008/09	1643	1100	2450	1176	1250	944	883	741		10187
Abstenim nga viti paraprak		55%	-105%	4%	2%	17%	8%	13%		-1%
Viti shkollor 2009/10	1399	1523	1009	2315	1187	1007	834	763		10037
Abstenim nga viti paraprak		7%	8%	6%	-1%	19%	12%	14%		9%
Viti shkollor 2010/11	1287	1338	1375	951	2320	998	909	755		9933
Abstenim nga viti paraprak		4%	10%	6%	0%	16%	10%	9%		8%
Viti shkollor 2011/12	1318	1166	1216	1206	985	1930	944	766		9531
Abstenim nga viti paraprak		9%	9%	12%	-4%	17%	5%	16%		9%
Viti shkollor 2012/13	1209	1303	1139	1195	1187	991	1878	728		9630
Abstenim nga viti paraprak		1%	2%	2%	2%	-1%	3%	23%		0.0
Viti shkollor 2013/14	1314	1145	1180	1062	1118	1140	933	1445		9337
Abstenim nga viti paraprak		5%	9%	7%	6%	4%	6%	23%		9%
Viti shkollor 2014/15	1131	1238	1112	1043	954	1049	963	658	685	8833
Abstenim nga viti paraprak		6%	3%	12%	10%	6%	16%	29%	53%	17%
Viti shkollor 2015/16	1247	1154	1177	999	972	913	900	816	607	8785
Abstenim nga viti paraprak		-2%	5%	10%	7%	4%	14%	15%	8%	8%
Viti shkollor 2016/17	1497	1219	1099	1115	941	946	840	811	747	9215
Abstenim nga viti paraprak		2%	5%	5%	6%	3%	8%	10%	8%	6%
Mesatarja 2006-2016 (nga një vit në tjetrin)										8%
Nga 2008/2009-2016/17										60%

Fotografia nr.2: Abstenenca e nxënësve romë në kuadër të shkollimit fillor

Kur kemi të bëjmë me abstinencën e këtyre nxënësve në kuadër të shkollimit të mesëm, mesatarja e abstinencës nga njëri, në vitin tjetër shkollor arrinë shifrën deri në 15%

Viti shkollor 2005/2006	I	II	III	IV	Gjithsej/Mesatarja
	464	303	262	191	1220
Viti shkollor 2006/2007	419	405	293	180	1297
Abstenim nga viti paraprak		13%	3%		8%
Viti shkollor 2007/2008	406	347	348	205	1306
Abstenim nga viti paraprak		17%	14%		16%
Viti shkollor 2008/2009	550	353	322	236	1461
Abstenim nga viti paraprak		13%	7%		10%
Viti shkollor 2009/2010	701	414	272	241	1628
Abstenim nga viti paraprak		25%	23%		24%
Viti shkollor 2010/2011	585	485	348	218	1636
Abstenim nga viti paraprak		31%	16%		23%
Viti shkollor 2011/2012	517	459	445	233	1654
Abstenim nga viti paraprak		22%	8%		15%
Viti shkollor 2012/2013	539	469	403	306	1717
Abstenim nga viti paraprak		9%	12%		11%
Viti shkollor 2013/2014	570	460	391	267	1688
Abstenim nga viti paraprak		15%	17%		16%
Viti shkollor 2014/2015	509	415	399	237	1560
Abstenim nga viti paraprak		27%	13%		20%
Viti shkollor 2015/2016	446	357	346	271	1420
Abstenim nga viti paraprak		30%	17%		23%
Viti shkollor 2016/2017	409	423	345	232	1409
Abstenim nga viti paraprak		5%	3%		4%
Mesatarja 2006-2016					15%

Fotografia 3: Abstenenca e nxënësve romë në kuadër të shkollimit të mesëm

Njëra ndër masat që ndërmerret për reduktimin e abstenimit është edhe dhënia e bursës të nxënësve romë në shkollat e mesme, gjë që është e rregulluar me ligj, si dhe vendosja e mediatorëve të arsimit të cilët duhet të sigurojnë mbështetje afatgjatë për nxënësit romë në kuadër të shkollimit fillor.

Secili fëmijë/nxënës në Maqedoni, duhet të ketë qasje të barabartë deri në arsimim cilësor. Kjo do të thotë që secili duhet të ketë trajtim të barabartë, të ketë poashtu një mësues/profesor cilësor, ashtu si edhe arsimimi (fillor dhe i mesëm) që duhet të jetë falas në me plot kuptimin e fjalës. Por, situata në terren flet për një sërë parregullsishë.

Për shembull, në lagjen Vizbeg ku jetojnë me mijëra banorë, për shkak të mungesës së shkollës, mbi 800 nxënës të kësaj lagje, janë të detyruar që mësimin ta ndjekin nëpër shkollat fillore të disa komunave përreth.

Nxënësit e fshatit Bllacë të Shkupit për vite me rradhë, në këmbë kalojnë rreth 6 kilometra, ata kalojnë kufirin maqedono-kosovar, në mënyrë që shkollimin e tyre ta ndjekin në komunën e Hanit të Elezit. Shkollë fillore në këtë fshat nuk ka, ndërsa shteti ua mohon një të drejtë njerëzore, të drejtën e arsimimit. Këta nxënës nuk kanë kushte për ndjekjen e mësimin në vendin e tyre të lindjes, por pritet që procesi arsimor në vitin 2021 të mund të ndiqet më afër shtëpive të tyre. Në fakt, është planifikuar ndërtimi i një godine të re shkollore gjatë vitit 2021, ku këta nxënës të këtij fshati do ta fillojnë vitin shkollor në fshatin e tyre, por se a do të realizohet plani në fjalë, do të tregojë koha.


Janë të shumtë shembujt e shkollave pa kushte elementare të funksionimit , pa ujë, pa tualete. Në territorin e R. së Maqedonisë së Veriut ekziston pabarazi e theksuar në qasjen deri te uji i pijshëm dhe sanitimi ndërmjet shkollave fillore dhe të mesme në mjediset rurale dhe urbane. Në vitin 2015, në kuadër të Programit të Shëndetit Publik, në katër objekte shkollore në të cilat kanë ujësjellësin e tyre, të gjitha nga komuna e Likovës, është hasur koncentrim më i madh i arsenit, përderisa në vitin 2017, një nivel i lartë i koncentrimit të arsenit është hasur edhe në tri objekte shkollore në fshatin Llojan.

3.5. Analizë e intervistave të realizuara me qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut


Për nevojat e kësaj teze të magistraturës janë zhvilluar tre intervista me persona të bashkësive të ndryshme etnike (një maqedonas me nevoja të veçanta, një shqiptar dhe një rom), nga gjini, moshë dhe nivel të ndryshëm të arsimimit. Qëllimi i realizimit të intervistave është përfitimi i të dhënave, të cilat do të ndihmonin në pranimin/refuzimin e hipotezave të dhëna. Pjesëmarrja e personave të intervistuar ishte në mënyrë vullnetare dhe anonime. Personat të cilët dhanë intervistë, paraprakisht ishin të njoftuar me qëllimet (pse intervistohen) dhe në çdo moment përgjatë intervistës kishin mundësi të abstenojnë apo ta ndërpresin të njejtën, në rast se ndjenin nevojë për ta bërë këtë.

Struktura demografike e të intervistuar është vijuesja:

- Përkatësia etnike: maqedonas – 1, shqiptar 1, rom – 1,
- Gjinia: mashkullore – 1; femërore – 2.
- Moshë: 18-25 (1 person); 26-35 (1 person); 36-45 (1 person).
- Arsimi: i mesëm-1 person, i lartë-2 persona.



Grafikoni 1: Përkatësia etnike Grafikoni 2: Gjinia



Grafikoni3: MoshaGrafikoni4: Niveli i arsimit

Intervista përbëhet nga pesë pyetje të hapura, përgjigjet e të cilave janë të paraqitura në Tabelën 1.

Tabela 1: Përgjigjet e intervistës

Pyetja e 1: Sipas mendimit tuaj, a respektohet në tërësi e drejta e arsimimit dhe mosdiskriminimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut?
Personi i 1: Edhe pse në përputhje me regullativën ligjore, fëmijët me nevoja të veçanta, nuk guxon të jenë të anashkaluar nga procesi arsimor, vetë fakti i mosprezenës fizike deri dhe në ndërtesat e shkollës, flet për sjelljen deklarative në raport me të drejtën e arsimimit. Në fakt, është tejet i vogël numri i shkollave që posedojnë tragjesë në hyrje të shkollës, ndërsa për gjerat tjera as që vlen të flasim. Dhe gjithmonë arsyetimi qëndron në mungesën e mjeteve financiare. Nënvlërësimi i aftësive të fëmijëve me nevoja të veçanta, si dhe trajnimi i pamjaftueshëm i mësimitdhënësve për të punuar me këtë kategori fëmijësh, është krejtësisht çështje tjetër.
Personi 2: Në vitet e fundit, ky vend ka bërë shumë, sa i përket të drejtës së arsimimit. Por edhe pse arsimit fillor dhe ai i mesëm janë obligativ, një numër i madh i nxënësve romë, nuk e realizojnë këtë të drejtë. Për këtë problem, janë të vetedijshëm të gjithë, por kam përshtypjen se askush nuk mërzhitet për këtë grup të marginalizuar, e as që kam dëgjuar për ndonjë aksion nga ana e trupave përkatës qeveritar. Për mos vijimin e mësimi, janë paraprë dënime në të holla, por këto dënime vetëm sa do t'a përkeqësojnë edhe më tepër, edhe ashtu gjenden tashmë të përkësuar ekonomike të familjeve.
Personi i 3: Kam qenë dëshmitare e praktikës, se si një fëmijë i një etniteti tjetër të refuzohet nga një shkollë “tërheqëse” por edhe “etnikisht e pastër”, me arsyetimin se nuk ka vend të mjaftueshëm. Për disa nxënës të vlejshëm disa rregulla, ndërsa për disa të tjerët këto rregulla të tjera. Ligj ka, por shumë lehtë gjinden mënyra për të “dalë nga situata”. Ajo që më pengon, ka të bëjë me faktin e pranimit të nxënësve të cilët shfrytëzohen apo përdoren në kuadër të mësimi. Në klasat më të vogël, tekstet në pjesën më të madhe të tyre promovojnë kuptimin tradicional dhe stereotip të rolit të gruas në shoqëri.
Pyetja e 2: Si i vlerësoni kornizat aktuale ligjore/normative që kanë të bëjnë me të drejtën e arsimimit?
Personi 1: Shumica prej tyre janë vetëm deklarative
Personi 2: Janë shumë në letër, por në praktikë...
Personi 3: Ndryshimet e fundit në Ligjin për Arsim Fillor mendoj se janë të mira dhe se kanë kontribuar shumë në drejtim të ndryshimit të disa situatave. Por ekzistojnë edhe zgjidhje ligjore të cilat kanë shkaktuar situatë kaotike. Në këtë mënyrë, e drejta e arsimimit është falas dhe obligative, por kjo është e kushtëzuar me vërtetim për pranimin e vaksinës. Çfarë janë ata fëmijë, prindërit e të cilëve refuzojnë t'i vaksinojnë?
Pyetja e 3: Çfarë mendoni, cila është arsya kryesore për mosrealizimin e së drejtës së arsimimit?

Personi i 1: Vetëdija e pamjaftueshme rreth vlerës së arsimit
Person i 2: Varfëria e cila është edhe arsya për shumë njerëz , sidomos për romët, për t'u nisur për punë jashtë vendit, apo nga ana tjetër, fëmijët e tyre t'i angazhojnë me ndonjë punë.
Personi i 3: Edukata patriarkale sa u përket vajzave, mungesa e të hollave për të blerë veshje dhe pajisje shkollore, kufizimi i prindërve të cilët nuk dëshirojnë ta lëshojnë në shkollë fëmijën në rast se i njeiti është me nevoja të veçanta, etj.
Pyetja e 4: Sipas jush cilat hapa duhet të ndërmerren në mënyrë që të përmirësohet gjendja e së drjtës së arsimimit dhe mosdiskriminimit?
Personi i 1: Implementimi i ligjeve edhe në praktikë
Personi i 2: Të zhvillohen kampanja të vazhdueshme masovike rreth rëndësisë së arsimimit, të ndikohet kundrejtë vetëdijes së njerëzve, si dhe të përmirësohet standardi jetësor
Personi i 3: Për çdo shkollë në të cilën mëson fëmijë me nevoja të veçanta, të angazhohet defektolog. Jam kundër praktikës së tanishme momentale të cilën e praktikojnë një numër i madh i komunave të cilët angazhojnë një defektolog që duhet të punojë në të gjitha shkollat e komunës. Kjo është vetëm pro forme në këtë mënyrë, defektologu nuk ka mundësi që në mënyrë cilësore të punojë me fëmijët, në rast se ai, i sheh dhe takon ata vetëm një herë në javë.
Pyetja e 5: Çfarë do të kishit theksuar që është relevante me temën, e që nuk ishte e përfshirë në kuadër të pyetjeve?
Personi i 1: Mendoj se secili fëmijë me nevoja të veçanta duhet të punojë me defektolog ose me asistent personal. Nuk pajtohem me praktikën momentale, që asistentët personal të kenë arsimim të çfardoshëm. Mendoj se ata duhet të jenë persona të cilët megjithatë kanë të bëjnë me arsimin (pedagogë, mësimdhënës të papunësuar, psikologë).
Personi i 2: Në kuadër të sistemit tonë arsimor, i kushtohet kujdes formës, e shumë më pak përmbajtjes. Këtu mësimdhënësit në mënyrë të vazhdueshme ankohen në mbingarkesë me punët administrative, ndërsa nxënësit ankohen në mbingarkesë të lëndëve mësimore. Përveç së drejtës së arsimimit, mendoj se fëmijët nga ana tjetër, kanë të drejtën edhe të arsimimit cilësor, ndërsa të gjithë jemi të vetëdijshëm se arsimi në Maqedoninë e Veriut nuk është i nivelit të tillë. Gjithçka bëhet brenda natës. Të gjitha ndryshimet dhe reformat miratohen, pa u pilotuar paraprakisht dhe pa u parë rezultatet nga ndryshimet gjegjëse. Duhet punuar shumë në aspektin e zhvillimit dhe ngritjes së vetëdijes te grupet e prekura, për atë se çfarë do të thotë arsimimi por kjo mos të jetë një, dy kampanja dhe me kaq të përfundojë gjithçka. Nevojiten strategji afatgjate dhe të mirëplanifikuara, me të cilat do të ndryshojë mënyra e të menduarit. Nevojiten më tepër bursa që do t'u ndahen grupeve të prekura.
Personi i 3: Njëra ndër punët që mendoj se mungon, është baza elektronike kombëtare, me anë të së cilës do të mbahet evidenca e fëmijëve të ciët nuk e realizojnë të drejtën e arsimimit. Duhet të ekzistojë edhe lidhshmëri ndërmjet shërbimeve të caktuara, të cilat në terren do të vërtetojnë shkaqet

që një fëmijë i caktuar nuk vijon mësimin, dhe në bazë të kësaj duhet të ketë një paletë masash që do ta detyrojnë fëmijën të ulët në bankat shkollore. Sa i përket diskriminimit, nevojitet edhe edukim i kuadrit mësimdhënës, por edhe i nxënësve, së pari për t'u njohur, e më pas edhe për t'i mësuar mënyrat se si të reagojnë. Në kuadër të shoqërisë tradicionale dhe patriarkale, procesi i ndryshimit të punëve, është teje vështirë, por vetëm me anë të edukimit, këmbënguljes dhe vazhdimsisë, mund të arrihen qëllimet e vendosura.

Rekomandime dhe konkluzë përmbyllëse

Arsimi është njëri ndër shtyllat bazik në të cilën mbështet çdo bashkësi, dhe në kuptimin më të gjerë edhe shteti, si dhe e gjithë bota globalisht. Që moti, tashmë për të gjithë është e qartë se pa arsimim, nuk mund të ketë as përparim shoqëror.

Për minoritetet etnike, e drejta e arsimimit, ka rëndësi të jashtëzakonshme për ruajtjen dhe sigurinë e identitetit të tyre kulturor. Arsimimi gjithashtu mund të inicojë mirëkuptim, respekt dhe miqësi ndërmjet grupeve etnike dhe fetare, si dhe të ndihmojnë në ndërtimin e kulturës së të drejtave universale të njeriut.

Arsimimi është interes kombëtar i secilit shtet dhe domosdoshmërisht duhet të jetë mbi nevojat ideologjike dhe politike, që e ndjekin ndryshimin e diskursit politik. Vendet progresive, njohën rëndësinë e arsimimit si çelësin e zhvillimit dhe përparimit të tyre dhe vendosën theksin në të, që në fëmijërinë e hershme duke e ndjekur dhe duke e potencuar mundësinë e arsimimit gjatë jetës, edhe pas përfundimit të arsimit formal. Për faktin se njohuritë dhe shkathtësitë e vazhdueshme bëhen gjithnjë e më të vjetra, gjithnjë e më tepër kemi nevojë për të mësuarit gjatë gjithë jetës..

Arsimimi duhet të jetë prioritet në tërë botën, e jo privilegj për minoritetin, sepse vetëm njerëzit e arsimuar mirëfilli, jo vetëm që mund të kontribuojnë, por edhe të jenë inicues të aktiviteteve shoqërore. Secili që është i përfshirë në kuadër të procesit arsimor, pa marrë parasysh a është edukator, apo nxënës, është pjesë e krijimit të klimës në suazat e rrethit të tij të verprimit. Për të siguruar ardhmëri cilësore për të gjithë, sidomos për të rinjtë, ashtu si edhe e meritojnë, askush nuk duhet të qëndrojë indiferent ndaj arsimit. Arsimimi është bazë për përfitimin, zgjerimin dhe pasurimin e përvojës, së rritjes dhe zhvillimit individual, si dhe i përfitimit të shkathtësisve të ndryshme. Për t'i arritur qëllimet, arsimimi duhet të përqëndrohet dhe të përshtatet, në mënyrë që t'i ndjek trendet e reja dhe nevojat e tregut. Por, parë në këndvështrimin më të gjerë, arsimimi i tillë nuk guxon të shihet vetëm si përfitim të njohurive për profesionin për të cilin studiojmë, e as për përgatitje të mëtejme për punë. Arsimimi ofron mundësi për zhvillimin e personalitetit, zhvillimin e ndjenjës për të mirën dhe të keqen, për të vertetën dhe të rrejshmen dhe për të drejtën dhe të pa drejtën. Edhe kjo është po aq e rëndësishme, sepse arsimimi është njëri ndër themelet e jetës dhe nevojës ekzistenciale të secilës qenie njerëzore. Ky është procesi i cili zhvillohet në kuadër

të institucioneve të arsimit, por edhe jashtë tyre. Arsimi është njëkohësisht edhe proces shoqëror dhe dëshmia më e madhe për këtë është suksesi i tij. Asnjëherë nuk arrijnë deri në fundin e tij, por paraqet trasim të rrugës për realizimin e të gjitha vlerave.

E drejta e arsimimit mbi të cilën në mënyrë të barabartë, ka të drejtë çdo njeri prej nesh, në mënyrë universale dhe të vazhdueshme. Kjo është e njëjtë për të gjitha qeniet njerëzore, kudoqoftë në botë. Kjo e drejtë është e pacënueshme, nuk mund të humbet, por është edhe e drejtë e pandashme dhe e pavarur ku së bashku me të drejtat tjera, ndërton një kornizë komplementare. E drejta e arsimimit, është pasqyrim apo rezultat i nevojave themelore të njeriut, pa të cilët njerëzit nuk mund denjësisht të jetojnë. Përfolja e kësaj të drejte do të thotë kërkim të respektimit të dinjitetit njerëzor. Me pranimin e kësaj të drejte, merren edhe përgjegjësi: respektimi i së drejtave të tjetrit, si dhe mbrojtja dhe mbështetja e atyre, e drejta e të cilëve është e cënuar apo e mohuar. E drejta e arsimimit nënkupton dispozicionin e arsimimit edukativ, e cilësisë dhe institucioneve në kuadër të arsimimit edukativ, gjë që nënkupton edhe përvojë, mundësi për zgjedhje të edukimit dhe arsimimit sipas dëshirës dhe nevojës personale, por edhe të drejtën për një mjedis të sigurt, inkurajues dhe edukativ në të cilin do të respektohen të drejtat e fëmijëve, mësimmësuesve, prindërve dhe të drejtat e të gjithë pjesëmarrësve të tjerë.

Analiza e raporteve dhe e rregullativës ligjore e cila është zbatuar në këtë tezë të magistraturës, është në dispozicion të hipotezës së parë, me anë të së cilës dëshmohet se sigurimi i qasjes në arsim, është parakusht për realizimin e plotë të së drejtës së arsimimit. Në këtë mënyrë, mossaigurimi i qasjes deri në shkollat për fëmijët me nevoja të veçanta, ua shkurton të drejtën e arsimimit, në shkollat të cilat zhvillojnë programin e zakonshëm edukativo-arsimor. Qasja deri në arsimim është problem edhe për shumë fëmijë të tjerë të cilët nuk posedojnë dokumentacion përkatës (certifikatë të lindjes) gjë që paraqet pengesë të theksuar, të paktën në mjediset tona, për të realizuar të drejtën e arsimimit. Qasja deri në arsimim, paraqet problem dhe për shuicën fëmijëve që vijnë nga mjediset rurale, të cilët ndonjëherë duhet të kalojnë edhe nga disa kilometra, për të arritur në shkollën më të afërt.

Nga përmbajtja e tezës së magistraturës mund të vërejmë se një numër i madh i normave juridike, kanë të bëjnë me të drejtën e arsimimit. Por edhe pse të njëjtat, janë pranuar nga shumë vende, realiteti sa i përket implementimit të kësaj të drejte, është krejtësisht ndryshe. Për këtë, flet edhe fakti që sot vetëm 1 nga 5 vende, në mënyrë ligjore

garanton 12 vite shkollim falas dhe obligativ⁴². Edhe përkundër arritjeve të ndryshme në të vendeve të nivelit botëror, paralajmërimet nga ana e OKMB-së dhe nga ana e ekspertëve të politikës globale, thonë se avancimi global në fushën e arsimit „la pas vetes“ me miliona fëmijë dhe të rinj. Për këtë flasin edhe numrat nga hulumtimi i prezantuar, sipas të cilit, në tërë botën, më se 120 milionë fëmijë dhe adoleshentë, nuk janë pjesë e orëve të mësimi. Më shumë fëmijë dhe adoleshentë janë të ekspozuar ndaj rrezikut të braktisjes së shkollimit, ndërsa shumica, nëpër shkolla përballen me kushte të papërshtatshme për të mësuar. Me këtë, vërtetohet edhe hipoteza e dytë, sipas së cilës implementimi i së drejtës së arsimimit, që del nga një numër i madh i normave juridike ndërkombëtare, është pjesërisht i realizueshëm.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e drejta e arsimimit është e garantuar me Kushtetutë, përmes ligjeve dhe përmes një numri të caktuar të marrëveshjeve ndërkombëtare. Por, lirisht mund të themi që kjo e drejtë është e garantuar vetëm në mënyrë deklarative. Pse? Edhe përkundër të gjitha përpjekjeve, Maqedonia në një sërë raportesh ndërkombëtare, sa i përket së drejtës së arsimimit, është thirrur të ndërmarrë masa serioze. Njëra ndër verëjtjet kryesore nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, sa i përket së drejtës së arsimimit, vjen nga Komisioni i Lartë për Pakicat Kombëtare, i cili tërheq vërejtjen në lidhje me „trendin alarmand të ndasive etnike në vend“⁴³. Është fakt se, në të gjitha raportet që nga viti 2010 e këndej, Obdusmani, vazhdimisht i kushton vëmendje, segregacionit (ndarja e një pjesë, njëra prej tjetrës, apo ndarja në pjesë e masës së përgjithshme) në suazat e arsimimit, në baza etnike dhe gjuhësore, gjë që ka qenë si lëndë e proceseve gjyqësore në disa nga vendet europiane⁴⁴. Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe me rregullativën ligjore në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, segregacioni merret si formë e ashpër e diskriminimit, dhe i njëjti sipas së drejtës ndërkombëtare, është i ndaluar. Në ligjdhënien e RMV-së, segregacioni si term, haset shumë rrallë, por edhe nuk trajtohet si formë e diskriminimit. Njëra nga arsytet e paraqitjes së segregacionit, është gjithsesi politika e zbatimit joparimor të riorganizimit gjatë regjistrimit nëpër shkolla. Gjithashtu, problem tjetër në kuadër të së drejtës së arsimimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, paraqet edhe mos përkufizimi i përgjegjësisë ligjore, të cilat i kanë organet shtetërore dhe institucionet, sa i përket diskriminimit, duke përfshirë edhe

⁴²<https://gemreportunesco.wordpress.com/2018/11/05/education-is-not-a-privilege-its-a-legal-right/>, qasur më 03.06.2020

⁴³ Petroska-Beška, V., Najčevska M., Kenig N., Ballazhi S., Tomovska A. (2009). Study on Multiculturalism and Inter-Ethnic Relations in Education. Skopje: UNICEF.

⁴⁴https://fosm.mk/wp-content/uploads/publications/Segregacija%20Romi_WEB.pdf, qasur më 04.06.2020

diskriminimin në fushën e arsimit. Mes tjerash, në Republikën e Maqedonisë së Veriut edhe gjyqet edhe Obdusmani, si dhe Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, kanë të drejtë të veprojnë kundrejt çështjeve të diskriminimit, por jo ende nuk ekziston përcaktim i qartë, se në cilin rast, cili nga organet e lartëpërmenduar, duhet të veprojë. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përmes zgjidhjeve ligjore, kërkohet arritja e një niveli të kënaqshëm të rinisë së arsimuar, apo përqindje e ulët e popullatës analfabete, por njëkohësisht kërkohen edhe punë të pamundura, duhe hasur në kufizime, ku vjen edhe deri te diskriminimi në baza të ndryshme. Shembull për një sjellje të këtillë është edhe puna e një numri të madh të shoqatave qytetare, të cilat personat i shpejnë në drejtim të mësimi të shkrim leximit, ku personat në fjalë në asnjë moment më parë, nuk i janë qasur procesit arsimor dhe megjithatë nuk kanë mundësi të kenë as dokument valid në lidhje me avancimin e tyre. Çështje tjetër është arsimimi inkluziv. Me ligjin e ri për arsim fillor, inkluziviteti në arsim, hyri përmes portës së madhe. Por shumë punë mbetën të papërfunduara apo të pazgjidhura... Shembull për këtë është edhe momenti i përpilimit të programeve operative individuale për fëmijët me nevoja të veçanta. Në esencë, për secilin fëmijë me nevoja të veçanta, mësimdhënsi me ndihmën e shërbimit profesional, prindërve, etj, duhet të përgatitë program individual me qëllimet të cilat duhet të arrihen. Në rast të njëjtat arrihen, në përputhje me mundësitë e fëmijës, vendosen qëllime më të mëdha, ndërsa në rastin e kundërt, të njëjtat reduktohen. Krijimi i programeve në fjalë, më shpesh realizohet në atë mënyrë që nga materiali hiqet pjesa të cilën fëmija nuk ka mundësi ta mësojë apo përvetësojë. Nuk ekziston zgjidhje sistematike, për adaptimin e programit, sipas mundësive të fëmijëve me nevoja të veçanta, e bazuar mbi barrierat të cilat nevojitet të tejkalohen, e nga ana tjetër, nuk ekziston as zgjidhje sistematike, rreth vlerësimit, se pse nuk janë arritur qëllimet e parapara, por se kjo bëhet vetëm sipas interpretimit të vetë mësimdhënësit. Problem paraqet edhe notimi, gjegjësisht testi i maturës. Në këtë mënyrë, fëmijët me nevoja të veçanta, mësojnë sipas programeve të veçuara individuale, por gjatë testit të maturës, për shembull, ata duhet t'i nënshtrohen testimit sipas programit të rregullt mësimor – sepse ende nuk janë përgatitur, përshtatur teste, sipas llojit të nevojave të veçanta, e nga ana tjetër, këtyre fëmijëve, nuk u është lejuar koha shtesë për zgjidhjen e testit. Në kuadër të ligjeve të RMV-së, më shumë në mënyrë deklarative promovohet inkluziviteti, ku fitohet përshtypja se „inkluzioni është përjashtim, ndërsa ndarja rregull“⁴⁵. Për shkak të shembujve të shumtë të këtij lloji, që kanë të bëjnë me

⁴⁵<http://ombudsman.mk/upload/Istrazuvanja/2016/Inkluzivno%20obrazovanie-UNICEF-Mk.pdf> qasur

parregullsitë edhe në kuadër të ligjdhënies maqedonase edhe në praktikën reale maqedonase, mund të vërtetojmë hipotezën, sipas të cilës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në mënyrë deklarative, është e garantuar e drejta e arsimimit, e shprehur përmes Kushtetutës me anë të ligjdhënies dhe ligjeve, si dhe përmes rekomandimeve dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare.

Vëretjet dhe rekomandimet, të prezantuar në kaptiullin e tretë, nga trupat për të drejtat e njeriut pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Këshillit Evropian dhe Komisionit Evropian, si dhe analiza nga përgjigjet e intervistës, tregojnë se Republika e Maqedonisë së Veriut, nuk e respekton në tërësi të drejtën e arsimimit dhe parimin e mosdiskriminimit, gjë që dëshmohet sipas hipotezës së katërt. Nga kjo, buron edhe dëshmia e hipotezës së pestë (por edhe rekomandimet e trupave ndërkombëtare shpien në atë drejtim) se Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nën përgjegjësinë e së cilës, mes tjerash, është krijimi dhe vërtetimi i politikave të zbatimit të ligjeve, të propozojë ligje, të japë mendim në lidhje me ligjet e propozuara dhe rregullave të tjera, duhet të bëjë më tepër përpjekje për zbatimin e së drejtës së arsimimit dhe parimit të mos diskriminimit.

Të kuptuarit në tërësi, sa i përket së drejtës së njeriut për t'u arsimuar, realizohet në fazën e veprimit: paraqitjes së kundërvajtjeve, sanksionimit të kryerësve, korigjimin e aktiviteteve të papërshtatshme dhe jo të drejta dhe në të ardhmen, parandalim të mosrespektimit, e për këtë puna cilësore pedagogjike përpos të mësuarit, mbështetjes së nxënësve dhe sigurimit të mjedisit stimulativ material, nënkupton edhe promovimin e së drejtave të njeriut dhe të fëmijëve, si parakusht për përmirsimin e jetës së fëmijëve dhe prosperitetit të shoqërisë. Arsimi është e drejtë njerëzore, e mirë dhe përgjegjësi publike. Përmes arsimimit bëhemi më të mirë.

Bibliografia

- AKKERMANS, Piet. *Education laë and policy in an urban society: yearbook of the European Association for Education Laë and Policy. Volume II* (1997), The Hague: Kluëer Laë International , 1999
- ANDREEVSKA, Elena. *International Laë and Human Rights*, SEEU, Tetovo, 2005
- ANDREEVSKA, Elena. *Osnovi na megjunarodnoto javno pravo*, SEEU, Tetovo, 2008
- ANDREEVSKA, Elena. *Вонредните правни лекови како средство за заштита на човековите права и слободи согласно домашното и меѓународното право*, Agencija Akademik, Skopje 1999
- BROCK, Colin. *Education in a single Europe*, Routledge, London, 1999
- CROSSLEY, Michael. ĖATSON, Keith. *Comparative and international research in education: globalization, context and difference*, Routledge/Falmer, London, 2003.
- COMMITTEE ON ECONOMIC, SOCIAL AND CULTURAL RIGHTS, ‘*General Comment No. 13: The right to education (article 13)*’, E/C.12/1999/10, December 1999
- DĖORKIN, R. *Sovereign Virtue: The Theory and Practice of Equality*, Cambridge, Harvard University Press, 2000
- FISZBEIN, ARIEL. *Decentralizing education in transition societies: case studies from Central and Eastern Europe*, Ėorld Bank Publications, Ėashington, 2001
- GROOF, Jan de . *No person shall be denied the right to education: the influence of the European Convention on human right to education and rights in education*, Nijmegen: Ėolf Legal Publishers (ĖLP), 2005
- GROOF, Jan de . *Cultural and educational rights in the enlarged Europe*, Nijmegen: Ėolf Legal Publishers (ĖLP), 2005
- GROOF, Jan de. Glenn, Charles Leslie. *Balancing freedom, autonomy and accountability in education*, Nijmegen: Ėolf Legal Publishers (ĖLP), 2005

- GVOZDENOVIĆ, Slavka: *Filosofija, obrazovanje, nastava*, Zavod za udžbenike i nastavna sredstva, Podgorica, 2005
- HARPER, Kate, et al., *Ending Physical and Humiliating Punishment of Children: Manual for Action, Save the Children Sëeden/International Save the Children Alliance*, Stockholm, 2005.
- HOFTIJZER, M., STRONKOËSKI,P, & ROZENBAUM, J. *Getting out of school and into theëorkplace: strengthening ëork-based learning in upper secondary technical education in Poland's Šëiętokrzyskie Region*. Ëorld Bank, Ëashington D.C., 2018
- HUDSON, Brian. *Teacher education policy in Europe: a voice of higher education institutions*, Umea University, Umea, 2008
- ИСАХИ-ПАЛОШИ, А., ВАСИЛЕСКА, Л., ТРПЧЕСКА, Л., СПАСОВСКИ, Г., СТОЈКОВСКА- АЛЕКСОВА, Р., И CRABTREE, D. *Инклузија во средното стручно образование: прирачник за работа со ученици со посебни образовни потреби*. Британски совет во Македонија, Скопје, 2014
- JANIS Mark Ë. KAY Richard S. BRADLEY Anthony Ë. *E drejta evropiane e të drejtave të njeriut*, Libri shkollor, Prishtine, 2002
- JASHARI, H. *Sociologjia e arsimit*. Interlingua, Shkup, 2005
- KULIĆ, R. / DESPOTOVIĆ, M. *Uvod u andragogiju*. Dom štampe Zenica, Zenica, 2005
- KUKA, E. *Imperativ prosperiteta*. KNS-Udruženje za kulturu Novo Sarajevo, Sarajevo, 2010
- LANGFORD, GLENN & O'CONNOR D. J. *Neë Essays in the Philosophy of Education*, Routledge & Kegan Paul Ltd., London, 1973
- LOËË, Roy. *History of Education: major themes*, Routledge/Falmer, London, 2000
- MELCHIORRE Angela, *At Ëhat age?...are school children employed, married and taken to court?*, 2nd ed., Right to Education Project, Lund, 2004

- MOJSOSKA-BLAZEVSKI NIKICA, & RISTOVSKA M. *Mapping of VET educational policies and practices for social inclusion and social cohesion Country Study: Former Yugoslav Republic of Macedonia*. European Training Foundation, 2013
- НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА. *Вклученост на децата и младите со попреченост во редовното средно образование: извештај од истражување*, Скопје, 2018
- PETROSKA-BEŠKA, V., NAJČEVSKA M., KENIG N., BALLAZHI S., TOMOVSKA A. *Study on Multiculturalism and Inter-Ethnic Relations in Education*. UNICEF, Skopje, 2009
- PINHEIRO, PAULO SÉRGIO, *The World Report on Violence Against Children, Report by the Independent Expert for the United Nations Secretary-General's Study on Violence against Children, Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights*, United Nations Children's Fund and the World Health Organization. Geneva, 2006
- ПОПОСКА, Ж., ШАВРЕСКИ З., и КОЧОСКА Е. *Законите и политиките на Република Македонија на полето на попреченоста*. Отворете гипрозорците, Скопје, 2015
- REKA, Blerim. *E drejta e Unionit Evropian*, Instituti i Kosovës për integritet euro-atlantik KIEAI, Prishtine, 2000
- REKA, Blerim. *E drejta nderkombetare dhe e drejta evropiane*, UEJL, Tetove, 2006
- REKA, Blerim. *EU Constitution: rubicon of supranational*, Skopje, Logos-A, 2007
- REKA, Blerim. IBRAHIMI, Arta. *Studime Evropiane: Identiteti, historia, integriteti evropian, Institutionet, politika, e drejta e Unionit Evropian*, UEJL, Tetove, 2004
- REKA, Blerim. SELA, Ylber. *Hyrje në drejtën e Unionit Evropian*, SEEU, Tetovo, 2007
- REKA, Blerim. SELA, Ylber. OTMAR, Holl. *Institutionet dhe politikat e Unionit Evropian*, SEEU, Tetovo, 2010

SAKURAI, Riho, 'Child Labour and Education', background paper prepared for the Education for All Global Monitoring Report 2007, United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization, 2006, p. 28.

СПАСОВСКИ Огнен. *Сегрегација на Ромите во образованието во Република Македонија*!?, Фондација отворено општество - Македонија, Скопје, 2015

TOMAŠEVSKI, K. *Human rights obligations in education: The 4-A Scheme*. Eölf Legal Publishers, Nijmegen, 2006

UNITED NATIONS EDUCATIONAL, SCIENTIFIC AND CULTURAL ORGANIZATION, *EFA Global Monitoring Report 2002: Is the world on track?*, UNESCO, Paris, 2002, p. 106.

UNITED NATIONS CONVENTION ON THE RIGHTS OF THE CHILD, article 32; and International Labour Organization Convention 182.

UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND, *The 'Rights' Start to Life: A statistical analysis of birth registration*, UNICEF, New York, 2005, pp. 3–4.

UNICEF, *A Human Rights-Based Approach to EDUCATION FOR ALL*, 2007, достапно: https://www.unicef.org/publications/files/A_Human_Rights_Based_Approach_to_Education_for_All.pdf, пристапено на 18.04.2020

Устав на РС Македонија,
<https://www.sobranie.mk/content/Odluki%20USTAV/UstavSRSM.pdf>, qasur më 04.05.2020

ATKINS, K. *Education Noë: Break the Cycle of Poverty* Oxford: Oxfam International, 1999

Закон за основно образование, достапен на <https://www.pravdiko.mk/ep-content/uploads/2013/11/Zakon-za-osnovno-obrazovanie-05-08-2019.pdf>, qasur më 04.05.2020

Закон за средно образование, достапен на линкот http://mon.gov.mk/images/Закон_за_средното_образование_пречистен.pdf, qasur më 07.05.2020

ZGAGA, Pavel. *The prospects of teacher education in south-east Europe*, Pedagogshki fakulteta, Ljubljana, 2006

Burime nga interneti:

https://unicode.org/udhr/d/udhr_mkd.html, qasur më 15.04.2020

https://www.right-to-education.org/sites/right-to-education.org/files/resource-attachments/RTE_International_Instruments_Right_to_Education_2014.pdf, qasur më 15.04.2020

<https://www.right-to-education.org/page/united-nations-instruments>, qasur më 16.04.2020

<https://www.hrë.org/report/2016/06/09/education-deficit/failures-protect-and-fulfill-right-education-through-global>, qasur më 29.04.2020

<https://en.unesco.org/neës/ëhat-you-need-knoë-about-right-education>, qasur më 29.04.2020

<https://en.unesco.org/nëës/ëhat-you-need-knoë-about-right-education>, qasur më 23.04.2020

<https://www.right-to-education.org/page/report>, qasur më 24.04.2020

<http://www.pravo.org.mk/documentDetail.php?id=88>, qasur më 07.05.2020

<https://mvr.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20stranci%2097-18.pdf>, qasur më 07.05.2020

<https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/MKindex.aspx>, qasur më 10.05.2020

<https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G18/341/06/PDF/G1834106.pdf?OpenElement>, qasur më 10.05.2020

ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G18/343/58/PDF/G1834358.pdf?OpenElement, qasur më 10.05.2020

https://lib.ohchr.org/HRBodies/UPR/Documents/Session32/MK/HC_letter_North_Macedonia_ENG.pdf, qasur më 12.05.2020

file:///C:/Users/Lenovo%20V130/Downloads/Infographic_NorthMacedonia.pdf, qasur më 14.05.2020

<https://rm.coe.int/leaflet-ecri-2019/168094b101>, qasur më 20.05.2020

<https://www.coe.int/en/ëeb/european-commission-against-racism-and-intolerance/-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia->, qasur më 21.05.2020

<https://rm.coe.int/fifth-report-on-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-macedonian-t/16808b590d>, qasur më 21.05.2020

<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-north-macedonia-report.pdf>, qasur më 23.05.2020

<https://gemreportunesco.ëordpress.com/2018/11/05/education-is-not-a-privilege-its-a-legal-right/>, qasur më 03.06.2020

https://fosm.mk/ëp-content/uploads/publications/Segregacija%20Romi_ËEB.pdf, qasur më 04.06.2020

<http://ombudsman.mk/upload/Istrazuvanja/2016/Inkluzivno%20obrazovanie-UNICEF-Mk.pdf>, qasur më 10.06.2020